



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 579 Akti

Nr.509 Vendimi
Tiranë, më 17.2.2022

VE N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

Asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta/Albana Plaka në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 15.2.2022, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Edlira Cufi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi do të shqyrtohet nga trupi gjykues, i cili përbëhet nga komisionerët, Alma Faskaj relatore, Suela Zhegu kryesuese dhe Etleda Çiftja anëtar.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raporte të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

4. ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Edlira Cufi, duke krahasuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting* me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

5. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

6. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Edlira Cufi, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

7. DISK-ja ka dërguar në Komision, gjithashtu, informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit dhe ka dërguar raportin për kontrollin e figurës, të deklasifikuar pjesërisht me vendim nr.***, datë 16.9.2021, në të cilin informon se;

- i. gjatë periudhës në të cilën znj. Edlira Cufi ushtronte detyrën si prokurore dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive;
- ii. në lidhje me subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi, jemi informuar edhe mbi të dhëna që disponohen për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- iii. gjithashtu, nga veprimet verifikuese, kanë informuar Prokurorinë e Përgjithshme.

Në përfundim, Grupi i Punës, nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga *përshatshmëri* për vazhdimin e detyrës në *papërshatshmëri* në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi.

8. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr.84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

9. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 20.6.2020, të trupit gjykues nr.3, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues komisionere Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

10. Në datën 22.11.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datën 9.12.2020 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

11. Në datën 13.1.2022, trupi gjykues me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

12. Po në të njëjtën datë, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë, brenda datës 27.1.2022.

13. Në datën 31.1.2022, pas dërgimit të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit në datën 27.1.2022, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes.

14. Në datën 11.2.2022, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 15.2.2022, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

15. Në datën 15.2.2022 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte e pranishme.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

17. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

18. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj.Edlira Cufi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj,duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit,sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën E shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Parashikime të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregulla të posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22. Sipas kreut IV të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23. Sipas kreut V të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

24. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse. Referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr.84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr.84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara, ndër vite, dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekt i dërguar në Komision;(d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, nëpër puthje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD-ja; (ë) denoncime të publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A.RIVLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërinë e burimit dhe të krijimit të saj.

28. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Edlira Cufi.

29. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privat e për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

30. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2008 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

31. Subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur), në datën 26.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

32. Subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi ka ushtruar këto detyra:

- në periudhën korrik 1995 – 1998 prokurore në Prokurorinë e Rrethit Malësi e Madhe;
- zëvendës drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Shkodër për periudhën 2008 – 2013;
- nga viti 2013 dhe në vijim prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

A/1. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

❖ Pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*

1. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri në pronësi të saj.

Subjekti nuk deklaroi pasuri në deklaratën *Vetting*, por i bashkëlidh deklaratës dokumentacionin¹ e fitimit të pasurisë të llojit apartament me sip. 64 m², nr.***, z. k. ***, vol.***, f.***, në bashkëpronësi me shtetasit V, M, Edlira dhe A.C.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

1.1 Në arkivën dixhitale të ASHK-së rezultoi se subjekti i rivlerësimit është bashkëpronar në pasurinë apartament me sip. 64 m², nr.***, z. k. ***, vol. *** f.***, së bashku me shtetasit V, M, Edlira dhe A.C. Pasuria është fituar me akt shitblerjen nr. ***, datë 22.12.1993, nga Ndërmarrja Komonale Banesa dhe është regjistruar në ZVRPR-në Shkodër, në datën 16.1.2012.

1.2 Nga hetimi rezultoi se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit V.C, ka kontratë Nr. *** dhe është abonentë pranë OSHEE-së, si dhe ka kontratë me nr.***, zona **, kod kontrate ***,

¹Shihni Aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

të lidhur me Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, të cilat iu përkasin pasurisë së sipëranalizuar, në të cilën subjekti jeton së bashku me prindërit².

1.2.1 Rezulton nga hetimi se subjekti ka deklaruar në DIPP-të për vitet 2003 – 2013, adresë banimi lagjja “****”, rruga “****”, p. ***, Shkodër, por nuk ka deklaruar bashkëpronësinë me ¼ pjesë takuese në këtë pasuri. Ndërkohë që nuk ka deklaruar adresë banimi në DIPP-të periodike të viteve 2014 – 2018 dhe as në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

1.2.2 Në përfundim të hetimit, në analizë të provave të administruara nga organet e vetëqeverisjes vendore, institucione të tjera dhe pyetësorët e subjektit, rezultoi e provuar se e vetmja adresë në të cilën subjekti ka jetuar është, pikërisht, pasuria apartament e ndodhur në Shkodër, në bashkëpronësi të saj me prindërit dhe motrën. Pavarësisht adresave të ndryshme të deklaruara, rezultoi e provuar se ndryshimet kanë të bëjnë më ndryshimin e adresarit të qytetit dhe nuk dhanë *indicie* për pasuri tjetër të përdorur nga subjekti i rivlerësimit³.

Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë

1.3 Nga hetimi rezultoi se kjo pasuri është përfituar përpara fillimit të detyrës të subjektit në zbatim të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në datën 15.10.1993, me përfitues kryefamiljarin V.C, me vlerë pagese 5,357 lekë.

1.4 ISSH-ja konfirmoi se deri në janar të vitit 1993, babai i subjektit V.C, ka qenë i punësuar në Ndërmarrjen Pyjore Shkodër, ndërsa nëna e subjektit M.C, prej muajit gusht të vitit 1993, ka përfituar pension pleqërie me masë mujore 24,324 lekë. Trupi gjykues, duke u nisur nga periudha e hershme e fitimit të pasurisë, e cila është përpara fillimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe për shkak të vlerës së ulët të pagesës për apartament, çmon se familjarët e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi të kryejnë pagesën për përfitimin e kësaj pasurie.

1.5 Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, trupi gjykues i kërkoi shpjegime subjektit si vijon:

➤ Subjekti rivlerësimit nuk ka deklaruar bashkëpronësinë mbi apartamentin dhe as adresën e banimit në deklaratën *Vetting*.

1.6 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se: *“Për sa është konstatuar nga ana e juaj në këtë pikë unë e kam theksuar dhe po ritheksoj: adresa e shtëpisë ku unë kam deklaruar që në fillim (dhe ku aktualisht banoj), ka qenë lagjja ‘***’, rruga ‘***’, pall. ***, Shkodër, gjë të cilën e kam provuar dhe me aktin e marrjes në pronësi (pasi ashtu ka qenë emërtimi në atë kohë). Duke qenë se unë kam paraqitur aktin ku unë jam bashkëpronar e kam thënë dhe po e ricitoj me idenë se kur është e shkruar, çfarë vlere ka thënia bashkëpronar, kur ndërkohë kam përcjell certifikatën e pronësisë. Qëllimi i pyetësorëve të procesit të rivlerësimit, në dijeninë time, është që subjektet të korrigjojnë gabimet apo harresat e bëra më parë në deklaratat e mëparshme periodike”.*

Qëndrimi i subjektit në seancë dëgjimore

1.7 Në seancë dëgjimore subjekti mbajti të njëjtin qëndrim, si edhe në parashtrimet e dhëna pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Vlerësimi i Komisionit

1.8 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se subjekti ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës *Vetting* dhe DIPP-të e viteve 2014 – 2016. Depozitimi në deklaratën *Vetting* i dokumentacionit, lidhur me mënyrën e

²Shkresat: nr. *** prot., datë 6.10.2021; nr. *** prot., datë 7.2.2020, e OSHEE-së, nr. *** prot., datë 19.10.2021, pyetësor nr. 4 pyetja nr. 2; si dhe pyetësor nr. 1, përgjigjja nr. 1.

³Shkresat: nr. *** prot., datë 2.7.2021, nga Gjendja Civile; nr. *** prot., datë 14.10.2021. nga Bashkia Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave e Bashkisë Shkodër,

fitimit të kësaj pasurie, e kalon këtë pasaktësi dhe, për pasojë, e përjashton subjektin nga përgjegjësia administrative për këtë pasaktësi të konstatuar.

❖ **Angazhimet private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara**

2. Në deklaratën *Vetting*⁴ subjekti i rivlerësimit deklaron: “Paga për vitin dhe periudhën 1.10.2015 – 31.12.2015 janë të ardhura bruto në vlerën 434,322 lekë dhe të ardhura neto në vlerën 263,348 lekë”.

2.1 Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën *Vetting* edhe në DIPP-të e viteve 2003 – 2016, mbi deklarimin e të ardhurave vjetore me burim pagat dhe mos deklarim në vitet 2005, 2006 dhe 2008. Shuma totale e të ardhurave nga paga të deklaruara në DIPP-të të viteve 2003 – 2016, rezultojnë të jenë 12,597,013 lekë.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

2.2 Në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit rezultoi se në dosjen hetimore të subjektit vlera totale e të ardhurave me burim pagën, të përfituara gjatë ushtrimit të detyrës dhe të përfshira në analizën financiare e të konfirmuara nga institucionet punëdhënëse për periudhën 2003-2016, është 17,284,523 lekë⁵.

2.3 Komisioni, pasi mori në analizë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës *Vetting*. E pyetur nga Komisioni subjekti, ndër të tjera, shpjegoi se: “... është evident fakti se ka ndodhur një lapsus gjatë plotësimit të deklaratës *Vetting*...”⁶.

2.4 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me sa më lart.

Qëndrimi i subjektit

2.5 Subjekti në shpjegimet e dhëna pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 15.2.2022 mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të dhëna gjatë hetimit.

Vlerësimi i Komisionit

2.6 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se janë bindëse, mosdeklarimi i tyre në DIPP-të periodike dhe në deklaratën *Vetting* konsiderohet pasaktësi. Trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklarime nuk lidhen me deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të pikës 3, tënenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për dhënien e masës disiplinore shkarkim nga detyra, por do të vlerësohen në tërësinë e elementëve dhe kriterëve të vlerësimit për subjektin.

3. Detyrimet e subjektit të deklaruara në deklaratën *Vetting*

3.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* në seksionin detyrime ndaj personave fizik dhe juridikë ka deklaruar: “*RFZ, dega *** Shkodër, nr. llogarisë ***, shuma e kredisë 300,000 lekë, interesi 9.9%, afati 3 vite numri kësteve 36 kësti mujor 9,666,08 lekë data e këstit të parë më 2.8.2015, data e maturimit 16.7.2018. Për vitin 2016 janë shlyer interesat dhe këstet e kredisë së bashku me principalin dhe janë sipas pasqyrës përkatëse*”.

⁴Subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting* dokumentacionin nga institucionet ligjzbatuese mbi marrëdhënien e punësimit, deklaruar si burim i të ardhurave nga paga. Sipas vërtetimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për Edlira Cufi, periudha 1.10.2016 – 31.12.2016, rezulton se vlera totale *neto* për të ardhurat nga paga është 263,348 lekë.

⁵Shkresë nr.*** prot., datë 4.12.2020, nga ISSH-ja.

⁶Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve vërtetim nr.*** prot., datë 14.6.2021, nga ku rezulton se për vitin 2015 paga *neto* është në vlerën 1,359,640 lekë dhe për vitin 2016 paga *neto* 1,128,298 lekë.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni⁷

3.2 Nga shkresa e përcjellë në Komision nga “RFZ” rezulton se kjo kredi është tërhequr *cash* nga subjekti në datën 22.7.2015 dhe është shlyer totalisht në datën 16.7.2018.

Vlerësimi i Komisionit

3.3 Në analizë të shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit në raport me tërësinë e provave të administruar, trupi gjykues çmoi se deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* përpunet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit.

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi gjendje *cash*, kursime dhe depozita brenda ose jashtë sistemit bankar në DIPP-të periodike, duke filluar nga viti 2003, kur është bërë subjekt për herë të parë dhe në vijim dhe, gjithashtu, edhe në deklaratën *Vetting* nuk deklaroi likuiditete gjendje *cash* apo kursime.

4. GJETJE TË TJERA

Depozitë kursimi e subjektit të rivlerësimit në “RFZ”⁸, në vlerën 103,964 lekë, krijuar në datën 1.10.2004

4.1 Depozita është maturuar në datën 1.8.2005, në vlerën 106,106.3 lekë. Komisioni kreu analizën financiare të paraqitur në tabelën vijuese dhe nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë depozitën në vlerën 103,964 lekë, me të ardhurat nga paga gjatë periudhës 1.1.2004 – 1.10.2004.

<i>Analiza financiare</i>	<i>1.1.2004 – 1.10.2004 (vlerat në lekë)</i>
Të ardhura të babait të subjektit	230 832
Të ardhura të nënës së subjektit	218 916
Të ardhura të subjektit	645 108
Të ardhura nga depozitat në “RFZ”	923
Shpenzimet jetike të llogaritura për 3 anëtarë	281 892
Likuiditete në fillim të vitit	1 000 000
Likuiditete në fund të vitit	1 603 189
Rezultati financiar	210 698

4.2 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë depozitën me të ardhura të ligjshme, por nuk ka deklaruar në asnjë prej DIPP-ve vjetore të viteve 2003 – 2016 dhe as në deklaratën *Vetting* depozitën në “RFZ”, në vlerën 103,964 lekë, në vitin 2004.

4.3 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje për sa është konstatuar më sipër mbi depozitën në “RFZ”.

⁷Rezulton se subjekti e ka deklaruar për herë të parë si detyrim në DIPP-ë të vitit 2015 në të cilën në seksionin e detyrimeve ka deklaruar se: “RFZ, dega Shkodër në numrin e llogarisë ***, shuma e kredisë 300,000 lekë interesi 9.9 % afati në vite 3 numri i kësteve 36, kësti mujor 9,666.08 lekë data e pagesës së këstit të parë 2.8.2015 data e maturimit 16. 7.2018. Për vitin 2015 kam shlyer këstet e kredisë sipas interesit së bashku me principalin ”. Subjekti i bashkëlidh deklaratës *Vetting* dokumentacionin e përfitimit të kredisë. Kontratë kredie datë 16.7.2015 me palë kredidhënëse “RFZ” për dhënie kredie në shumën 300,000 lekë për arsye personale. Vërtetim mbi produktet bankare të klientit “RFZ”, datë 25.1.2017, ku vërtetohet se për subjektin gjendja e detyrimit në fund të vitit 2016 është 168,023 lekë.

⁸Shkresë nr.*** prot., datë 23.11.2020, nga “RFZ”.

Qëndrimi i subjektit

4.4 Subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim në shpjegimet e dhëna pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe në seancën dëgjimore të mbajtur në datën 15.2.2022, të cilat janë si vijojnë: *“...në lidhje më faktin e konstatuar nga ana e juaj, për të qenë realisht dhe transparent me Komisionin, as kam pasur dijeni për këtë fakt. Nga komunikimi me ‘RFZ’ kam marrë dijeni se kjo depozitë e cituar nga ana juaj është e para shumë vitesh dhe ka qenë tek Banka e Kursimeve (ku aktualisht është RFZ). Ajo llogari ka qenë llogari e pagës si prokurore në atë kohë (duke pasur një nr. llogarie), por më pas ka kaluar në rrogën time me nr. llogarie, siç është e përshkruar (pra, nuk kam llogari). Ajo është transportuar në rrogën time aktuale...”*

Vlerësimi i Komisionit

4.5 Trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka pasaktësi të deklarimeve periodike të mëparshme dhe në deklaratën Vetting. Trupa gjykuese çmon se pasaktësitë në deklarime nuk lidhen me deklarinin e pamjaftueshëm në kuptim të pikës 3, tënenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për dhënien e masës disiplinore shkarkim nga detyra, por do të vlerësohen në tërësinë e elementëve dhe kriterëve të vlerësimit për subjektin.

5. Personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit

5.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë Vetting nuk deklaroi as persona të lidhur dhe as persona të tjerë të lidhur.

5.2 Në analizë të pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: *“13. ‘Person i lidhur’ është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit”*, rezultoi se subjekti ka qenë në certifikatë familjare e vetme dhe është ndarë nga prindërit në datën 16.6.2001⁹

5.3 Subjekti, e pyetur nga Komisioni ¹⁰, në lidhje me deklarinin e personave që ka bashkëjetuar dhe kush ka paguar shpenzimet e jetesës për secilin vit, ka shpjeguar se: *“Gjatë gjithë kohës kam bashkëjetuar me prindërit e mi, pensionist, të cilët nuk rezultojnë në një certifikatë familjare, por efektivisht kanë jetuar me mua gjatë gjithë kohës. Shpenzimet e jetesës janë mbuluar bashkërisht nga unë dhe prindërit”*.

5.4 Në analizë të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet: *“Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”*.

5.5 Trupi gjykues çmon se, nisur nga fakti që prindërit e subjektit kanë bashkëjetuar me subjektin dhe kanë pasur një interes pasuror, mbulimin së bashku të shpenzimeve për një jetesë të përbashkët dhe krijimin e likuiditeteve nga prindërit, konsiderohen persona të tjerë të lidhur dhe subjekti ka pasur detyrimin për deklarim në deklaratën Vetting të likuiditeteve të tyre.

5.6 Ky konkluzion lidhet edhe me faktin se subjekti ka deklaruar se krijimi i këtyre likuiditeteve ka pasur burim kursimet familjare, të cilat kanë pasur si burim edhe të ardhurat e subjektit. Sa më sipër, subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte kursimet në fund të çdo viti, të cilat kanë shërbyer, gjithashtu, si burim i likuiditeteve të familjarëve të saj, pra, gjendjen e

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 2.7.2021.

¹⁰Pyetësor nr.1.

kursimeve *cash* të saj.

5.7 Sa më sipër, trupi gjykues kreu hetimin dhe analizën financiare edhe të personave të tjerë të lidhur, konkretisht babit V.C, nënës M.C dhe vëllait Y.C.

ANALIZA FINANCIARE E PERSONAVE TË TJERË TË LIDHUR

6. Depozitë bankare në BKTe prindërve të subjektit të rivlerësimit V dhe M. C

6.1 Rezultoi gjatë hetimit se prindërit e subjektit të rivlerësimit, shtetasit V dhe M.C, kanë pasur në BKT¹¹ depozitë kursimi dyemërore me nr. ***. Llogaria është hapur në datën 15.7.2014, në shumën 1,500,000 lekë, nga derdhja *cash* e vlerës së mësipërme, nga babai i subjektit V.C.

Lidhur me burimin e krijimit të depozitës

6.2 Komisioni konstatoi se z. V.C¹² ka pasur depozitë kursimi në vlerën 1,500,000 lekë, të çelur në datën 30.9.2004, në “RFZ”. Vlera e depozitës është tërhequr *cash* nga z. V.C në datën 13.12.2005, ku gjendja e saj ka qenë 1,607,957 lekë.

6.3 Subjekti, i pyetur¹³ nga Komisioni, për të provuar burimin e krijimit të saj, sqaron se: *“Në vitin 1992 deri në vitin 1997 babai im ka punuar si përkthyes në firmën ‘***’ sh.p.k., si përkthyes i gjuhës bullgare, me pronar A.K dhe se gjatë kësaj periudhe është paguar 300-400 USD muaj. Si rezultat i kursimeve familjare, ndër vite, si dhe të shitjes së një prone të gjyshit nga babai (ku babai im është përfitues) është depoiztuar shuma prej 1,500,000 lekësh. Shumë e cila sërish nga babai im është tërhequr dhe depozituar në BKT”*.

6.4 Gjatë hetimit nuk u arrit të përcaktohej se tërheqja e vlerës 1,607,957 lekë në “RFZ” e realizuar në datën 13.12.2005 ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës në BKT, nga derdhja *cash* e vlerës 1,500,000 lekë në datë 15.7.2014, për shkak të periudhës së gjatë të kohës midis dy transaksioneve.

6.5 Nga “RFZ”¹⁴ informohemi mbi historikun e krijimit të vlerës 1,500,000 lekë, për të cilën subjekti deklaroi se është origjina e depozitimit në BKT, në datën 15.7.2014. Referuar përmbajtës së shkresës së tyre¹⁵rezulton se në arkivat e “RFZ” (ish-Banka e Kursimeve) z. V.C ka pasur depozitat të çelura prej datës 26.8.1997 deri në datën 8.3.2004¹⁶.

6.6 Komisioni i drejtoi pyetje subjektit¹⁷ të rivlerësimit për të dhënë shpjegime mbi kontributin e saj në krijimin e depozitës dhe për kontributin e saj në mbulimin e shpenzimeve jetike të prindërve në periudhën e krijimit të depozitës. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të përcaktonte periudhën kohore në të cilën kanë jetuar me të prindërit, motra A.C dhe vëllai Y.C.

6.7 Lidhur me sa më sipër, subjekti sqaron se:¹⁸ *“Jo vetëm për periudhën që ju citoni, por që nga momenti që unë kam filluar punë deri sot unë kam dorëzuar në familje pjesën më të madhe të rrogës. Me përqindje nuk mund t’jua përcaktojë, pasi shpenzimet e familjes variojnë nga muaji në muaj, por di të them që unë e kam dorëzuar pjesën më të madhe të rrogës dhe kam mbajtur për vete një përqindje shumë të vogël, për shpenzime ditore/personale. Me*

¹¹Shkresë nr.*** prot., datë 16.12.2020, nga BKT.

¹²Shkresë nr.*** prot., datë 23.11.2020, nga “RFZ”.

¹³Pyetësor nr. 4, përgjigja nr.7.

¹⁴Shkresë nr.*** prot., datë 23.11.2020, nga “RFZ”.

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 30.9.2021.

¹⁶Depozitë nr.***, me afat 3-mujor, në shumën 100,000 lekë, datë 26.08.1997; depozitë nr.***, me afat 3-mujor, në shumën 107,800 lekë, në datën 26.2.1998; depozitë nr.***, me afat 3-mujor, në shumën 900,000 lekë datë 30.02.2001; depozitë nr.***, me afat 3-mujor, në shumën 1,000,000 lekë, datë 30.11.2002; depozitë nr.***, me afat 3-mujor, në shumën 600,000 lekë, datë 9.2.2004; depozitë nr.***, me afat 3-mujor, në shumën 1.400,000 lekë, në datë 8.3.2004.

¹⁷Pyetësor nr.6, përgjigje nr.4.

¹⁸Pyetësor nr.6, përgjigje nr.4.

ekonomi e familjes janë marrë prindërit e mi, ata kanë menaxhuar fondet që ne si familje kemi pasur në disponim, askush nuk ka mbajtur llogari sa dorëzoi apo kontribuoj secili në familje. Unë kam kontribuar, si e thashë më lart, duke dhënë pjesën më të madhe të rrogës në familje dhe duke mbajtur vetëm shpenzimet minimale ditore. Lidhur me pyetjen në fjalë sqarojë se rreth vitit 2000-2001 e në vijim motra ime A.C është larguar në Itali, ku dhe aktualisht jeton dhe nuk ka jetuar me ne nga kjo periudhë e në vijim. Po ashtu, vëllai Y.C që pas mbarimit të shkollës së mesme në moshën 18-vjeçare diku rreth vitit 1997-1998 në momentin që unë ka filluar shkollën e lartë në Tiranë, ka jetuar dhe punuar në Tiranë dhe nuk ka jetuar më me mua dhe prindërit e mi... ”.

6.8 Në vijim, Komisioni, nisur nga sa rezultoi nga provat e përcjella dhe bazuar në shpjegimet e dhëna nga subjekti, hartoi analizën financiare të paraqitur në tabelën vijuese, për krijimin e depozitës me kursimet nga paga për periudhën 1995 – 2005, si dhe të ardhurat e prindërve¹⁹:

<i>Analiza financiare</i>	<i>1995 - dhjetor 2005</i>
Të ardhura të babait të subjektit	2,718,688 Lekë
Të ardhura të nënës së subjektit	3,210,768 Lekë
Të ardhura të subjektit	4,446,535 Lekë
Të ardhura nga depozitat në Raiffeisen Bank	39,329 Lekë
Shpenzimet jetike të llogaritura për 5 anëtarë deri ne 1998, për 4 anetare deri ne 2001, dhe me pas vetem për 3 anetar	3,971,308 Lekë
Likuiditete në fillim të vitit	- Lekë
Likuiditete në fund të vitit	1,615,103 Lekë
Shpenzime udhetimesh	696,994 Lekë
Rezultati financiar	4,131,915 Lekë

6.9 Referuar analizës financiare sa më sipër rezultoi se subjekti dhe prindërit e saj kanë pasur mundësi të krijojnë depozitën në “RFZ”, deri në dhjetor të vitit 2005 në vlerën 1,607,957 lekë, me burim të ardhurat nga paga dhe pensionet e prindërve, pra, me burime të ligjshme.

Qëndrimi i subjektit

6.10 Lidhur sa më sipër, subjekti shpjegon se : “Llogaria në fjalë është vetëm e prindërve të mi dhe ata kanë pasur mundësi ta krijojnë këtë depozitë. Siç e kam cituar babai im ka punuar përkthyes, ka pasur tokë të babait të tij dhe e ka shitur, e njëjta vlen dhe për nënën time... Nuk

¹⁹(1) prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë të kenë përfituar të ardhura të mjaftueshme të provuara me dokumentacion ligjor për periudhën shkurt 1993 – 1995. Nga ISSH¹⁹-ë arkiva Lundër rezultoi dhe përcillet informacion mbi punësimet e babait të subjektit për periudhën 1.3.1952 – 20.1.1993 ku nga viti 1975 deri në janar 1993 është i punësuar pranë Ndërmarja Pyjore *** dhe pas kësaj periudhe, duke filluar nga muaji mars 1997 përfiton pension pleqërie me masë mujore 25,648 lekë. Në lidhje me nënën e subjektit të rivlerësimit rezultoi nga ISSH-ë se prej gusht 1993 përfiton pension pleqërie me masë mujore 24,324 lekë; (2) subjekti i rivlerësimit ka filluar ushtrimin e detyrës në korrik të 1995 dhe të ardhurat e saj të rezultuara nga dokumentacioni ligjor¹⁹ janë përfshirë në analizën e komisionit; (3) nuk janë përfshirë të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme të babait të saj të deklaruar më sipër në pyetësor, pasi nuk është përcjell dokumentacioni provues për shitjen e pasurisë; (4) nuk janë përfshirë të ardhura për motrën dhe vëllain e subjektit të rivlerësimit pasi nuk përcillet informacioni mbi të ardhurat e përfituara prej tyre. Ndërsa shpenzimet jetike në analizën financiare janë përfshirë sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorin nr. 6. Deri në vitin 1998 është përfshirë edhe vëllai i subjektit në shpenzimet jetike dhe deri në vitin 2001 është përfshirë edhe motra A.C. Ndërsa nga viti 1995 deri në vitin 2005 janë përfshirë shpenzimet jetike për prindërit e subjektit dhe subjektin e rivlerësimit; (5) Nuk janë përfshirë të ardhura nga puna si përkthyes të babait të subjektit në vitet 1993-1997 në shoqërinë “***” sh.p.k., me aksioner A.K, pasi nuk rezultoi prove e pagesave të tyre (të ardhurave nga paga) dhe nuk u provua shlyerja e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura.

kam detyrim për motrën dhe vëllain, pasi ata kanë qenë të ndarë nga unë. Subjekt i vlerësimit jam unë dhe jo familjarët e mi”.

Vlerësimi i Komisionit

6.11 Trupi gjykues çmon se, nisur nga fakti se subjekti ka pasur një ekonomi të përbashkët me prindërit e saj, ajo ka kontribuar si në mbulimin e shpenzimeve jetike të prindërve edhe në rritjen e aftësisë për kursim të tyre, e cila sjell, si rrjedhojë, edhe ndikim në krijimin e depozitës së kursimit të prindërve. Në zbatim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronte në deklaratën *Vetting* këtë llogari bankare dhe, për pasojë, duhet të deklaronte në DPV-të për vitet 2003-2005, kursimet e saj, të cilat kanë kontribuar në krijimin e llogarisë. Trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklarime nuk lidhen me deklarin e pamjaftueshëm në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për dhënien e masës disiplinore shkarkim nga detyra, por do të vlerësohen në tërësinë e elementëve dhe kriterëve të vlerësimit për subjektin.

7. Depozitë bankare në “Credins Bank” e prindërve të subjektit të rivlerësimit V dhe M.C

7.1 “Credins Bank”²⁰ informon Komisionin se shtetasit V dhe M.C kanë qenë klientë të bankës me llogarinë e depozitës nr. ***, hapur në datën 22.8.2008.

Në lidhje me burimin e krijimit të depozitës

7.2 Depozita dyemërore, në emër të shtetasve V dhe M.C, është krijuar nga derdhje *cash* të kryera gjatë viteve 2008– 2015²¹, të cilat rezultojnë në total në vlerën 3,146, 563, lekë, si në tabelën vijuese:

Data e depozitimit cash	22.8.2008	24.11.2008	23.2.2009	23.5.2009	23.11.2009	23.2.2010	24.5.2010	23.11.2010	23.5.2011
Vlera	350 000 Lekë	45 646 Lekë	95 027 Lekë	93 760 Lekë	92 240 Lekë	90 960 Lekë	100 000 Lekë	100 000 Lekë	78 930 Lekë
Data e depozitimit cash	23.11.2011	23.2.2012	23.5.2012	23.11.2012	23.2.2013	23.5.2013	23.11.2013	23.2.2015	24.8.2015
Vlera	100 000 Lekë	100 000 Lekë	100 000 Lekë	200 000 Lekë	100 000 Lekë	100 000 Lekë	200 000 Lekë	100 000 Lekë	100 000 Lekë

7.3 Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se prindërit e subjektit realizonin derdhje *cash* disa herë në vit, të cilat përkonin me vlerat e mbledhura të pensioneve të tyre gjatë asaj periudhe. Duke u nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerësoi se kjo depozitë është krijuar nga kursimi ndër vite (periudha para 2008 – 2015), nga të ardhurat nga pensioni i prindërve të subjektit të rivlerësimit, për të cilën analiza e burimit të krijimit është trajtuar si pjesë e analizës financiare të viteve 2003 – 2016.

Vlerësimi i Komisionit

7.4 Nga hetimi i kësaj pasurie nuk rezultuan problematika në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni për këtë pasuri vlerëson se shpjegimet dhe provat e administruara gjatë hetimit në dosjen hetimore janë bindëse dhe janë përfshirë në analizën ekonomike të kryer nga Komisioni.

8. Prona në përdorim të subjektit

8.1 Në pyetësin nr. 1, subjekti i rivlerësimit është pyetur²² nga Komisioni, nëse gjatë periudhës së deklarinimit ka përdorur prona të regjistruara në emrin e dikujt tjetër dhe në përgjigjen shpjegon se: “*Po, afërsisht nga viti 2012, kam përdorur mjetin me targa *** në pronësi të shtetasit A.H. Mjetin në fjalë, më pas e kam blerë me kontratën nr.***, datë*

²⁰Shkresë nr.*** prot., datë 9.12.2020, nga “Credins Bank”.

²¹Derdhje në datën 22.8.2008 – 24.8.2015.

²²Përgjigje e pyetjes nr.8, pyetësi standard.

23.07.2019. Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve dokumentacionin e blerjes dhe regjistrimit të automjetit tip "Volkswagen", me targa ***, në vitin 2019.

8.2 Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimi nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë Vetting dhe as në DIPP-të periodike për vitet 2012 – 2018, të drejtën e përdorimit të këtij automjeti. Subjekti shpjegon se: *"...nuk e kam deklaruar në DIPP-të të vitit 2012 për arsyen e vetme se nuk kam patur akt-përdorimi të mjetit në fjalë, por nuk ka qenë ndonjëherë qëllimi im ta fsheh përdorimin e këtij mjeti pasi nga momenti që e kam marrë tek pika e shitjes deri më sot kam shlyer të gjitha detyrimet e mjetit në emrin tim (taksa, kolaudim, siguracion). Mjetin në fjalë unë e kam marrë te një pikë shitje automjetesh , në dijeninë time e licensuar, në lagjen ***, Shkodër, me pronar A.H. Shitësi në fjalë e ka dërguar mjetin në fjalë tek kjo pikë shitje dhe e ka lënë për të shitur, unë nuk kam patur asnjë kontakt me shitësin real deri në momentin që ka ardhur për të nënshkruar kontratën e shitjes. Në kohën që kam marrë mjetin tek pika e shitjes z.H nuk ka qenë prezent dhe për këtë arsye nuk ka qenë e mundur të bëhej as akt përdorimi dhe akt shitje".*

8.3 Rezultoi se subjekti e ka përdorur këtë automjet pa akt përdorimi duke shpjeguar se: *"Mjetin me targa ***, e kam përdorur pa asnjë lloj dokumentacioni, pasi shitësi i mjetit ndodhej jashtë shtetit dhe mjetin e kam marrë nga pika e shitjes në mirëbesim, me idenë që kurdo të paraqitej shitësi, do të bënim kontratë shitjes. Shitësi është paraqitur shumë vonë për shkak të angazhimeve të tij personale. Lidhur me emrin e pikës së shitjes, siç e kam cituar dhe në përgjigjen e mëparshme shtetasi në fjalë, njihet si pika e shtetasit A.H ose B.Ll në përditshmëri. Taksat e mjetit janë paguar në emër të shtetasit A.H pronar i mjetit, pasi në kushtet kur unë nuk kisha një akt përdorimi apo një kontratë shitje nuk i bëja dot pagesat në emrin tim. Ama të gjitha pagesat janë bërë nga ana ime dhe kjo është lehtësisht e verifikueshme".*

8.4 Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në vitin 2019, subjekti shpjegon se: *"Automjeti në fjalë është blerë me të ardhurat nga paga si prokurore".*

8.5 Subjekti depozitoi gjatë procesit të rivlerësimit dokumentacionin si vijon: (i) ekstraktin historik të shoqërisë "****" sh.p.k., me administrator shtetasin A.H; (ii) aktin noterial, vërtetim nënshkrimi nr. ***rep., datë 17.6.2021, i vetëdeklarimit të shtetasit A.H, pronarit të pikës së shitjes së automjetit me targa ***. Në këtë akt shtetasi A.H ka deklaruar përpara noterit, ndër të tjera, si vijon: *" në Shkodër njihem ndryshe edhe si B.Ll. Prej mbi 10 vjet ushroj aktivitetin tim privat të shitjes dhe blerjes së mjeteve në lagjen ***, Shkodër dhe aktivitetin tim e kam të licensuar. Në vitin 2012 me sa ka kujtojë tek aktiviteti im ka ardhur shtetasi A.H, të cilin unë e njoh me emrin N. Në vijim, ky shtetas deklaroi se ia ka dhënë në mirëbesim mjetin subjekti të rivlerësimit, pasi me shitësin dhe babain e shitësit kishin marrëdhënie të afërta miqësie, ndërkohë ka njoftuar dhe shitësin që të vinte dhe të bënin dokumentet e shitjes".*

Hetimi /analiza ligjore dhe financiare i/e kryer nga Komisioni

8.6 Në DIPP-në e vitit 2019²³, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *"Automjet, veturë tip 'Golf', ngjyrë e zezë targa *** (bashkëlidhur aktin e shitjes), vlera 2,000 euro, likuiduar në cash".*

8.7 Nga hetimi rezulton se²⁴ me kontratën nr. ***, datë 23.7.2019, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip "Volkswagen", vit prodhimi 2001, me nr. shasie ***, me targa ***, në vlerën 2,000 euro nga shitësi, shtetasi A.H.

8.8 Në datën 30.2.2013, shtetasi A.H, me anë të kërkesës për regjistrim të mjetit rrugor, ka kërkuar të regjistrojë mjetin për herë të parë. Sipas deklaratës doganore rezulton se automjeti

²³Shkresë nr.*** prot., datë 14.6.2021, nga ILDKPKI-ja.

është importuar nga shtetasi A.H në datën 26.7.2012, nga shteti italian, me vlerë zhdoganimi 23,488 lekë.

8.9 Nga hetimi rezulton se²⁴në vitin 2012 rezulton pronar dhe përdorues shtetasi A.H dhe subjekti i rivlerësimit nuk rezulton përdorues, sikurse deklaroi gjatë procesit të rivlerësimit. Nga viti 2015 – 2018 subjekti rivlerësimit figuron përdorues ndërsa shtetasi A.H pronar.

8.10 Trupi gjykues hetoi nëse subjekti kishte ushtruar apo jo funksionin e saj në kushtet e konfliktit të interesit dhe, konkretisht, nëse kishte hetuar kallëzime apo procedime në ngarkim të shtetasve A.H dhe A.H dhe shoqërisë “****” sh.p.k., e cila ka për administrator shtetasin Z.H.

8.11 Subjekti, i pyetur nga Komisioni, shpjegoi se: “...nuk kam pasur asnjëherë në hetim gjatë ushtrimit të veprimtarisë time ndonjë kallëzim penal të bërë ndaj shtetasit H dhe H”.

8.12 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër²⁵ informon Komisionin se nuk rezulton të jenë hetuar procedime penale apo kallëzime në ngarkim të shtetasve A.H, A.H dhe shoqërisë “****” sh.p.k., nga subjekti i rivlerësimit.

8.13 Trupi gjykues, nga konsultimi me sistemin TIMS, konstatoi se shtetasi A.H, pronari i pikës së shitjes në të cilën subjekti ka marrë mjetin është proceduar penalisht në vitin 2012, për veprën penale “trafikimi i mjeteve motorike”, të parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal.

8.14 Mbi verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së informacionin sa më sipër, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër²⁶, e cila informon se në ngarkim të shtetasit A.H rezulton të jetë regjistruar procedimi penal me nr. ***.

Nga studimi akteve të procedimit penal nr. * rezultoi se:**

8.14.1 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal me nr.***, mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria e Policisë Shkodër për veprën penale të “trafikim i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a/1, i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A.H. Veprimet hetimore të procedimit penal nr.*** nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, por nga një prokuror tjetër, i cili në përfundim të hetimeve ka vendosur: “*Pushimin procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit A.H për kryerjen e veprës penale ‘trafikim i mjeteve motorike’, parashikuar nga neni 141/a/1 i Kodit Penal*”.

8.14.2 Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë duke ushtruar detyrën e zëvendësdrejtuese e Prokurorisë Shkodër për periudhën 2008 – 2013. Në ushtrim të kësaj detyre, subjekti ka miratuar vendimin e pushimit, si dhe ka kryer një sërë komunikimesh të tjera gjatë hetimit të kësaj çështjeje.

8.14.3 Referuar akteve të procedimit penal nr.***, të përcjella nga Prokuroria Shkodër, Komisioni konstatoi në fund të vendimit të pushimit të procedimit penal nr.***, shënimin me shkrim dore *zëvendësdrejtuese Edlira Cufi dhe nënshkrimin e saj*²⁷. Nënshkrimi i subjektit të rivlerësimit në ushtrim të funksionit të saj si zëvendësdrejtuese e Prokurorisë Shkodër, konstatohet edhe në disa nga aktet e tjera penale të këtij procedimi²⁸.

8.14.4 Nga hetimi rezultoi se njohja e ndërsjellë dhe kontakti me shtetasin A.H kanë qenë edhe përgjatë periudhës së kryerjes së hetimeve të procedimit penal nr.193/2012. Referuar

²⁴Shkresë nr.*** prot., datë 15.12.2020, nga AMF-ja.

²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 7.7.2021.

²⁶Faqe 4 e procedimit penal nr. ***.

²⁸Me shënimin P/dhe nënshkrimi Edlira Cufi në emrin e Prokurorit të Rrethit, si dhe në faqen 89, dokumenti në fund të fashikullit penal i quajtur “*lista e personave*” të cilët janë marrë me procedimin ku ka nënshkruar, drejtuesi i prokurorisë Shkodër, prokurori i çështjes, dhe subjekti i rivlerësimit.

edhe deklarimit të dhënë përpara noterit²⁹ nga shtetasi A.H, ku ai ka deklaruar se: “...shtetasja në fjalë kishte ardhur dhe më parë për të blerë një mjet...”.

8.14.5 Referuar praktikës së mjetit të përcjellë në Komision nga DPSHTRR-ë konstatohet, gjithashtu, se subjekti edhe pse nuk deklaroi datë të marrjes së mjetit në përdorim në vitin 2012, mjeti me targa *** është zhoguanuar në datën 30.2.2012, datë e cila është pothuaj një muaj më vonë se data e pushimit të procedimit penal nr.***, me vendim të datës 30.5.2012, në ngarkim të shtetasit A.H.

8.14.6 Përgjatë hetimit, Komisioni nga burime të paspecifikuara ra në dijeni të faktit se pronari i mjetit me targa ***, të përdorur dhe, më pas, të blerë nga subjekti, shtetasi A.H a N.H i datëlindjes 2.1.1978, rezultoi person me precedentë penal, duke përfshirë dhe kryerjen e veprave penale, të cilat bëjnë pjesë në gamën e veprave penale të përcaktuara shprehimisht në pikat 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i përfshirë në krimin e organizuar.

8.14.7 Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, bazuar në nenin “B”, pika 3/b³⁰, e Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, paraqiti disa gjetje lidhur me dënime dhe procedime penale të shtetasit A.H në shtetin Italian edhe për vepra penale³¹ të përcaktuara shprehimisht në pikat 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i përfshirë në krimin e organizuar.

8.14.8 Komisioni, së bashku me vëzhguesin e ONM-së, për verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së këtij informacioni, iu drejtuar institucioneve ligjzbatuese. Trupi gjyqësor verifikoi informacionet e klasifikuara të depozituara në Komision nga agjencitë ligjzbatuese, lidhur me gjendjen gjyqësore të shtetasit A.H. Këto informacione nuk i janë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit, pasi një pjesë e tyre janë të klasifikuara dhe në bazë të dispozitave ligjore, aksesit është i kufizuar.

8.15 Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës si vijon:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, por e ka deklaruar vetëm gjatë procesit të rivlerësimit përdorimin e një automjeti jo në pronësi të saj.
- ii. Veprimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me përdorimin e mjetit pa titull pronësie, janë veprime, të cilat cenojnë figurën e magjistratit dhe etikën e tij në kuptim të nenit 4 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 103,germat “ç” dhe “d” të tij.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka përfituar dhe ka përdorur pa kundërshtim për një periudhë 7-vjeçare, mjetin me targa ***, pothuaj 1 (një) muaj pasi janë mbyllur hetimet për procedimin penal nr.***, në ngarkim të shtetasit A.H.

²⁹Vërtetimi nënshkrimi nr. *** rep., datë 17.6.2021, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

³⁰ Neni B Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit 3/b paraqet gjetje dhe mendime mbi çështje që shqyrtohen nga Komisioni dhe nga Kolegji i Apelit, si dhe kontribuon për kontrollin e figurës sipas nenit DH.

³¹ 19.11.2002- mbajtje për shitje e lëndëve narkotike, në kundërshtim me nenin 73 të D.P.R Italian (akti legjislativ) n. ***; 17.6.2003- mbajtje për shitje e lëndëve narkotike, në kundërshtim me nenin 73 të D.P.R Italian (akti legjislativ) n. ***; 28.4.2006- mbajtje për shitje e lëndëve narkotike, në kundërshtim me nenin 73 të D.P.R Italian (akti legjislativ) n. ***; d)18.2.2008- mbajtje për shitje dhe transport i lëndëve narkotike, në kundërshtim me nenin 73 të D.P.R Italian (akti legjislativ) n.***; (e) 25.2.2009- mbajtje e lëndëve narkotike, në kundërshtim me nenin 73 të D.P.R Italian (akti legjislativ) n.***; (f) 11.2.2010-Import, transport i lëndëve narkotike në kundërshtim me nenin 73 të D.P.R Italian (akti legjislativ) n.***; (e) 17.12.2010 - mbajtje për shitje dhe transport i lëndëve narkotike, në kundërshtim me nenin 73 të D.P.R Italian (akti legjislativ) n.***; gjithashtu, z. H ka marrë disa dënime për vepra të tjera penale, si p.sh., shfrytëzim i prostitucionit dhe migrim i paligjshëm

- iv. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit, në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrim të funksioneve publike", i ndryshuar.
- v. Subjekti i rivlerësimit ka përdorur për një periudhë 7-vjeçare automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasit A.H, shtetas i cili rezultoi në përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit në pikave 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.
- vi. Subjekti rivlerësimit, për periudhën 2012 –2015, ka përdorur automjetin pa paguar detyrimet përkatëse.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

8.16 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti parashtroi:

Lidhur me pasaktësitë në deklaram: *"Lidhur me sa më lart, së pari theksoj që deklaramimi për herë të parë i përdorimit të këtij mjete gjatë procesit të rivlerësimit dhe jo gjatë deklaratave periodike vjetore është për shkak se në deklaratat periodike vjetore, më parë as sot, në asnjë rubrikë nuk kërkohet deklaramimi i pasurive në përdorim. Në deklaratat periodike kërkohet deklaramimi i pasurive të krijuara dhe ndryshimeve në pasur. I vetmi moment në të cilin na është kërkuar deklaramimi edhe i pasurive në përdorim ka qenë deklarata Vetting dhe pikërisht për këtë arsye nga ana ime është deklaruar vetëm në këtë moment përdorimi i mjetit. Një fakt të tillë e kam sqaruar dhe gjatë procesit".*

Lidhur me z. A.H: *"Lidhur me subjektin A.H, siç e kam theksuar edhe më parë, unë nuk kam pasur asnjëherë dijeni nëse ka qenë i dënuar. Vetë, personalisht, nuk e kam pasur kurrë në hetim, fakt i provuar dhe nga konfirmimet e prokurorisë".*

Lidhur me njohjen me z. A.H dhe kontaktet me të: *"As këtë shtetas unë nuk e kam pasur kurrë në hetim dhe as kam pasur dijeni se ka ndonjë procedim penal në ngarkim të tij. Fakti që kam firmosur miratimin e vendimit në fund të vendimit nuk më bën mua të jem në konflikt të interesit. Çështja është hetuar dhe pushuar nga një prokuror tjetër. Unë nuk kam objektivisht si të kemi dijeni për çdo çështje apo person të cilit i janë pushuar hetimet gjatë kohës që kam qenë zëvendës drejtuese. Në rast se vendimi i prokurorit të çështjes do të kishte qenë i ndryshëm dhe në këtë dosje do të kishte një akt të timin për shfuqizimin e këtij vendimi, atëherë mund të aludohej ndonjë shkak i mundshëm konflikti. Këtë procedim unë e kam cikluar rutinë siç kam cikluar shumë akte, shkresa, vendime gjatë kohës që kam qenë zëvendës drejtuese dhe nuk kam pasur asnjë ndikim në vendimmarrjen e prokurorit të çështjes".*

Qëndrimi i subjektit gjatë seancës dëgjimore

8.17 Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim, si edhe në parashtrimet e dhëna pas dërgimit të barrës së provës.

8.18 Në përgjigje të pyetjeve të trupit gjykues dhe vëzhguesit të ONM-së, subjekti, ndër të tjera, shpjegoi se:

Lidhur me njohjen me z. A.H dhe kontaktet me të: *"Me thënë të drejtën ne jemi njohur para vitit 2012 besoj. E njoh para vitit 2012 shtetasin A.H, tani unë p.sh., nuk i di makinat, në kuptimin nuk e di, nuk i njoh makinat, edhe normalisht merr një shok, një kushëri, ose do shkojmë për të parë një makinë se unë nuk e di, unë nuk jam as, çfarë i thonë elektroaut, as që rregullon makinat, që të shihja një makinë edhe me një çmim të arsyeshëm se s'kisha unë. Më pëlqeu, kam shkuar nja dy herë, nuk e di, po thashë po kjo? Ka ardhur një golf tha prej ka qenë i mirë. Po sa është çmimi? Ku di unë 4.000 a ku di unë, në atë kohë. I them, si i bëhet? Shohim thotë, a di pjesë e kësaj, si i thonë me thënë të drejtën s'i kam edhe lekët, prandaj edhe e sheh edhe bisedoj unë me atë që kur t'i kesh atje i them se unë nuk dua të marr i them*

një makinë pa letra se edhe duke punuar në prokurori thotë tjetri ti prokuror edhe makinë pa letra. Nuk ka problem tha se dal unë si me thënë, as i humbin lekët, as kurrëgjë. Kaloi madje nuk erdhi, si duket ai ka pasur punët e veta.

E njihja në fakt edhe ai më njihje mua si me thënë, si person i rregullt, i drejtë, e ke parasysh, ku di unë, mirëbesim kjo fjala, ku di unë tani.

Unë faktikisht, po s'e di, ky personi që thoni ju e njoh me A.Ll, a më kupton. Ne në atë kohë funksiononim me dy linja, pra ishte Drejtuesi i Prokurorisë dhe dy zëvendësa. Secili zëvendës kishte prokurorët e vet. Pra, unë kisha 7 a 8 edhe kolegja tjetër kishte 7 a 8, ku di unë. Vinin dosjet dhe ne i ciklonim se ndoshta kanë mbaruar, por pjesa, po themi, shfuqizimi i këtij vendimi i takonte drejtuesit se unë nuk mundesha të shfuqizoja vendim, a më kupton, sikur kanë kështu lidhje. Për arsye të ndryshme që mund të jenë mungesa të drejtuesit. Ne në fund të dosjes bënim shënimin p.sh., firmë ose ku e di unë ka qenë edhe shkruanim aty dosja kalonte te drejtuesi. Absolutisht nuk e kam ditur që filani është filani. Po, pashë që dosja ishte në rregull, prokurori që i kishte sjellë ishte prokuror i rregullt edhe kaluan edhe kaq. Po them makina është e rregullt, kjo tjetra është pushuar, letërporosia, dosjet po themi, ku di tani se s'i mbaj mend krejt në total ato.

Besoj, nuk e di tani, ndoshta mund të jetë edhe gabimi im, ku e di unë, po thjesht kur i beson një njeri, thua se unë i kam thënë vetë ma sill personin t'i bëj letrat se si marr unë makinë pa letra. Aq më tepër pastajtë dali personi sipas letrave që bini ju i dënuar. Ku kisha marrë unë makinë personit të dënuar, me dijeninë time”.

Subjekti i rivlerësimit dha shpjegime lidhur me çmimin 4,000 euro, të dakordësuar për mjetin, e deklaruar kjo vlerë gjatë seancës dëgjimore dhe çmimit 2,000 euro, sipas kontratës së shitjes në vitin 2019, si vijon:

“Hera e parë, ngaqë makina eci besoj eci 6-7 vjet, i them unë ka mundësi ta ulësh pak ...Pavarësisht se eci 7 vjet vlere e çmimit....Dhe ia thashë, nga momenti që kam marrë unë makinën deri në momentin e kontratës makina është konsumuar 7 vjet po themi, ka rënë, nuk është më ai çmim. E i thashë a ka mundësi të ma japësh të paktën 2-3.000 euro se ka rënë kjo makinë ...Asnjë gjë absolutisht, asnjëherë në dijeninë time...”

Çfarë lidhje kam unë me makinën aty. Ai tjetri i dënuar atje, unë në Shqipëri, unë s'e kam pasur kurrë, për zotin e madh, pasha këtë zot, kurrë. Bile edhe ditën që kemi shkuar të bëjmë kontratën unë kam qenë duke i dëgjuar ka thënë noteria ka ardhur personi. I thashë merrja firmën, jepja lekët se s'kam kohë ose thuajti të bëjë një.. ku e di unë.. Ku e kam ditur unë se është i dënuar ai. Më fal, ku është e shkruar ose po marrim pyetjen tjetër, pyetje mbi pyetje, që unë duhet të ble një makinë aty e t'i them, më falni, ju zotëri jeni i dënuar? Po si ble unë makinë te personat e dënuar me dy pare mend 26 vjet prokuror”.

Gjatë seancës dëgjimore subjekti u pyet lidhur me faktin nëse ka rënë dakord për vlerë e blerjes 4000 euro nga personi B.LL dhe nëse ka rënë dakord me shitësin e mjetit për këtë vlerë, pra nëse i është dashur të bëjë një marrëveshje lidhur me çmimin, apo thjesht mjeti është marrë pas asnjë marrëveshje. Në përgjigje të saj subjekti deklaroi:

“Po? Në vlerësim jo, pronari, pronari kishte vënë çmimin. Pronari i makinës A. H. që i sjell aty të pika e shitjes kishte thënë kjo makinë do shitet me këtë vlerë... Unë e kisha lënë domethënë që me të ardhur një herë pronari, të flisja me të dhe pastaj të bëja, po themi, pazar për çmimin”.

Në vijim e pyetur mbi dijeninë se personi me të cilin ka biseduar për çmimin nuk është shitësi dhe për dinamikën jo të zakonshme, rreziqet që mbart përdorimi i mjetit për 7 vjet pa asnjë marrëveshje me pronarin e mjetit dhe blerjen e tij në gjysmën e çmimit subjekti sqaron se:

“Po, kisha dijeni se nuk ishte ai pronari që fola unë, ishte shitësi ai. Pra, ishte një ndërmjetës. Unë e sqarova dhe pak më përpara qenia, fakti që personi më ka lënë mjetin në përdorim ishte thjesht që besonte që unë isha njeri serioz, korrekt dhe nuk kisha ku ta çoja makinën. Në qoftë se pronari do vinte, po themi ky i Italisë, vinte se do fliste për çmimin. Sa erdhi i thashë ma sill këtu se do bëj letrat se s’mund ta mbaj makinën pa letra. Kur të vinte t’ia tregoja unë”.

Vlerësimi i Komisionit

8.19 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe deklarimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, çmon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e saj si prokurore, duke marrë në përdorim një automjet për 7 vjet pa kundërshtim nga një person, i cili ka qenë subjekti i një procedimi penal i hetuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodërdhe i miratuar prej saj në cilësinë e saj si zëvendës drejtuese e prokurorisë, ka vepruar në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrim të funksioneve publike”³².
- Nenet 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet përkatësisht:
Në nenin 26: “...prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17...”, si dhe neni 17, germa “ë”: “... kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie”.
- Urdhrin nr.141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, ku parashikohet, ndër të tjera, se : “Prokurorët duhet të garantojnë zbatimin e rregullave që përcaktojnë parimet normat duke shmangur konfliktin e interesit”.
- Urdhrin nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e shkallës së parë”,ku parashikohet, ndër të tjera, se: “Vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjen për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë”.

8.20 Trupi gjykues çmon se mosveprimi i subjektit, për të finalizuar aktin e shitjes, aq më tepër në kushtet kur pronar i këtij automjeti rezulton të jetë një person me precedent penal për vepra penale të parashikuara nga neni 3 i ligjit nr. 84/2016, përbën një element shumë të rëndësishëm të etikës së një prokurori.

8.21 Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e saj, ka cenuar besimin e publikut te drejtësia. Për pasojë, duke marrë në konsideratë faktin se rikthimi i besimit të publikut te drejtësia është në themel të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

❖ ANALIZA FINANCIARE

9. Në vijim të analizës financiare,për periudhën 2003 –2016, të kryer mbi pasuritë e deklaruar në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike vjetore, ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet, nga

³²Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: 1. “konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike.

përlllogaritja e tyre është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të kursyera, me të ardhurat nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

9.1 Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i subjektit në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar, ka rezultuar fillimisht me një bilanc të përgjithshëm në vlerë negative 4,030,380 lekë, për të cilën subjektit iu kalua barra e provës sipas pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr.84/2016.

9.2 Në seancën dëgjimore të datës 15.2.2022, subjektit i është kërkuar përsëri të japë shpjegime lidhur me shpenzimet e përfshira në analizën financiare, të udhëtimit dhe qëndrimit të prindërve në shtetin italian. Relatorja e çështjes i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mbi diferencën në vlerën 400,000 lekë të rezultuar nga Komisioni në mungesë të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti lidhur me personin që ka mbuluar shpenzimet e prindërve në qëndrimin e tyre në Itali. Mbi këto shpenzime, subjekti shpjegoi se: *“... zakonisht, kuptohet bëhet fjala gjithmonë para pandemisë, edhe para pak vitesh sepse kanë relativisht dhe një moshë, por prindërit e mi kanë shkuar te motra ime, e cila është e martuar në Itali. Po e ke parasysh tani se edhe pleq, ata kanë idenë që do kursejmë dhe gjithmonë kanë gjetur një sezon qoftë bileta më të lira, qoftë atje, dhe kur kanë shkuar p.sh. ia ka rimbursuar motra çfarë ka pasurmundësi. Për të ngrënë dhe për të pirë kanë pirë aty se s’kanë shkuar të flenë në hotel se s’kanë pasur mundësi fjetjeje në hotel. Unë tani nuk e provoj që të them kanë fjetur”*. Relatorja e çështjes i kërkoi nëse ka dokument që provon se motra e subjektit jeton në Itali në kuptim të ligjit dhe orientimeve dhe jurisprudencës së Kolegjit për provueshmërinë e argumenteve gjatë procesit dhe subjekti përgjigjet: *“Nuk më është kërkuar mua kjo pjesë që motra jeton në Itali ... jo, nuk e kam ditur...unë kam thënë vetëm kaq, motra ka shkuar në Itali ...”*.

9.3 Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor, të cilat janë përcjellë pas kalimit të barrës së provës, si dhe analizoi qëndrimin e tij në seancën dëgjimore për rezultatin e analizës financiare të lidhur kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve dhe qëndrimit të prindërve, për të cilat janë llogaritur shpenzimet sipas metodologjisë së analizës financiare të Komisionit. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit është pyetur disa herë gjatë procesit të rivlerësimit³³ për të dhënë sqarime mbi udhëtimet dhe shpenzimet e tyre, duke i shoqëruar me dokumentacion provues për mbulimin e shpenzimeve nga persona të tretë, i cili nuk është përcjellë prej tij. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në arsyetimet dhe qëndrimet e mbajtura nga trupi gjykues, u arrit në konkluzionin se rezultati i analizës financiare të subjektit është në vlerën negative prej 2,754,791 lekësh.

³³ Pyetja nr. 12-13 e pyetësorit standard dhe pyetja nr. 9, pyetësori nr.4.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	503 974	111 129	-1 541 980	127 007	529 814	91 455	233 718	198 138	555 034	199 691	1 554 802	-157 123	5 072
1/4 bashkëpronësi e apartamentit me sip. 64 m2 me nr pasurie *** të ndodhur në Shkodër të fituar nga privatizimi, në vitin 1993.														
Automjet Golf, targë A***, në posedim nga viti 2012 dhe akti i blerjes në 2019, me vlerë 2,000 euro.														
Shtesa/pakësime likuiditete CASH dhe bankë	0	503 974	111 129	-1 541 980	127 007	529 814	91 455	233 718	198 138	555 034	199 691	1 554 802	-157 123	5 072
<i>Total likuiditete</i>	1 000 000	1 503 974	1 615 103	73 122	200 129	729 943	821 398	1 055 116	1 253 254	1 808 288	2 007 979	3 562 781	3 405 659	3 410 731
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	274 589	-89 723	-113 897	-78 311	260 624	-97 479
Kredi në vlerën 300,000 lekë në datë 27.07.2011									274 589	-89 723	-110 963	-73 904		
Kredi në vlerën 300,000 lekë në datë 16.07.2015													262 253	-94 230
Kartë krediti Edlira Cufi											-2 935	-4 408	-1 628	-3 249
PASURI NETO	0	503 974	111 129	-1 541 980	127 007	529 814	91 455	233 718	-76 451	644 757	313 589	1 633 113	-417 747	102 551
TË ARDHURA dokumentuar	1 202 103	1 475 900	1 514 863	1 521 076	1 452 133	1 727 087	1 832 275	1 708 176	1 881 144	1 949 972	1 779 916	1 989 322	1 967 676	1 970 880
Të ardhura të subjektit të rivlerësimit	602 439	860 144	891 962	921 412	852 469	1 123 068	1 205 892	1 067 801	1 237 336	1 294 244	1 113 545	1 336 885	1 330 077	1 342 688
Të ardhura të nënës së subjektit të rivlerësimit	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888	291 888
Të ardhura të babatit të subjektit të rivlerësimit	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776	307 776
Të ardhura nga depozitat në RBZ, BKT dhe Credins Bank		16 092	23 237			4 355	26 719	40 711	44 144	56 064	66 707	52 773	37 935	28 528
SHPENZIME	375 856	375 856	1 133 217	640 446	2 086 779	1 435 648	1 322 812	698 658	2 542 935	1 711 119	1 410 134	1 119 726	1 651 042	1 472 117
Shpenzime mobilimi 700,000 lekë i bërë ndër vite														
Shpenzime interesi kredia pranë Raiffeisen bank e vitit 2011									17 858	41 599	23 153	4 052		
Shpenzime interesi kredia pranë Raiffeisen bank e vitit 2015													10 583	21 763
Pagesë e realizuar nga subjekti nëpërmjet Alpha Bank për I** D**									331 920					
Shpenzime jetese	375 856	375 856	438 228	438 228	546 480	546 480	546 480	546 480	546 480	558 192	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhetimesh			694 989	202 218	1 540 299	889 168	776 332	152 178	1 646 677	1 111 328	822 885	235 683	743 354	509 986
Analiza dokumentuar	826 247	596 070	270 517	2 422 611	-761 653	-238 376	418 008	775 800	-585 340	-405 905	56 193	-763 518	734 382	396 212

Vlerësimi i Komisionit

9.4 Në vlerësim tërësor të provave të administruara në dosjen hetimore, shpjegimeve dhe deklarimeve të subjektit referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimin nr.***, datë 17.7.2018³⁴, në interpretim edhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, duhet të kuptohet që qëllimi i këtij procesi nuk është të vlerësojë dhe të hetojë nëse subjektet e rivlerësimit, ndër vite, kanë kryer ndonjë shkelje të ligjit për deklarimin e pasurive fillestare apo periodike, të cilat kanë qenë objekt i hetimit dhe verifikimit nga ILDKPKI-ja, që ka funksionuar si organ i zakonshëm dhe i përhershëm i vlerësimit të pasurisë së funksionarëve publikë. Qëllimi i këtij procesi është të vlerësohet nëse subjektet e rivlerësimit kanë fshehur pasuri apo nëse nuk e justifikojnë ligjërisht pasurinë e deklaruar sipas Aneksit të Kushtetutës. Në kontekstin e procesit të rivlerësimit, deklarimi i saktë dhe i plotë i burimit të krijimit të pasurisë dhe të ardhurave, si dhe ligjshmëria e këtij burimi është kusht thelbësor për të kaluar pozitivisht kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Konkluzion përfundimtar për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti në pyetësorët e dërguar, si dhe provat dhe parashtrimet në përgjigje të barrës së provës, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të tjerë të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të drejtën e përdorimit të një automjeti për një periudhë 7-vjeçare pa kundërshpërblim, nga një person që ka qenë në procedim penal nga Prokuroria Shkodër dhe miratuar vendimi i pushimit nga subjekti në cilësinë e zëvendësdrejtueses së kësaj prokurorie dhe aq më tepër nga një subjekt pronar, i cili rezultoi me precedent penal për vepra penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram të pamjaftueshëm të kriterit të pasurisë, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr.*** prot., datë 9.2.2021, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr.***, datë 5.2.2021, të KDZH-së për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku në përputhje me pikën 2 të po këtij neni, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Edlira Cufi.

³⁴Shihni faqet 29-30 të vendimit të Komisionit. Shihni: <http://www.kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-F.-Lulo-pdf.pdf> faqja 15 nga 59.

2. Komisioni kërkoi nga DSIK-ja përditësimin e raportit dhe kjo e fundit ka dërguar raportin për kontrollin e figurës, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 16.9.2021.

2.1 Në raportin e përditësuar, ndër të tjera, citohet se në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit rezultuan se: *“Gjatë periudhës në të cilën znj. Cufi ushtronte detyrën si prokurorë dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi, jemi informuar edhe mbi të dhëna që disponohen për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”*. Në përfundim, Grupi i Punës nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi.

2.2 Në vijim të procesit të vlerësimit të figurës, për një proces të rregullt ligjor, në kuptim edhe të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese Komisioni, në bashkëpunim me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit, pati akses në informacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese, për t'i studiuar ato, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura. Këto informacione janë të kufizuara për subjektin pasi janë të klasifikuara në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

2.3 Trupi gjykues, gjatë hetimit, iu drejtua subjekti të rivlerësimit, lidhur kontaktet e saj me disa shtetas, për të shpjeguar shpeshësinë e kontakteve, rrethanat e njohjes dhe për të përshkruar lidhjen me disa shtetas, të cilët rezultojnë se janë shtetas me precedentë penal për vepra penale të përcaktuara shprehimisht në pikat 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i përfshirë në krimin e organizuar.

Subjekti i rivlerësimit³⁵ shpjegoi se: *“Unë kam një karrierë të gjatë si prokurorë prej 26 vitesh, nga të cilat 3 vitet e para të punës i kam ushtruar në Malësinë e Madhe dhe periudhën në vazhdim në Shkodër. Gjatë këtyre viteve kam qenë zëvendës drejtuese e Prokurorisë për periudhën 2008 – 2013. Jam lindur dhe rritur në Shkodër. Për këtë arsye unë kam pasur kontakte me njerëz të ndryshëm, kontakte pune, shoqërie, miqësie, por me personat në fjalë nuk kam pasur raporte shoqërore, miqësie, lidhje farefisnore e mbi të gjitha në dijeninë time, nuk i kam pasur kurrë në hetim. I vetmi person me të cilin kam njohje nga personat e lartpërmendur nëse mund të quhet e tillë është shtetasi I.H, i cili është djali i xhaxhait i djalit të vajzës së xhaxhait tim, por gjithsesi as këtë shtetas nuk e kam pasur kurrë në hetim ...”*.

2.4 Trupi gjykues hetoi lidhur me kontaktet e subjektit, përkatësisht, me shtetasit L.K dhe I.H.

2.5 Për një hetim të plotë, objektiv dhe të thelluar për kontrollin e figurës, Komisioni iu drejtua organeve ligjzbatuese³⁶. Këto organe depozituan një dokumentacion të plotë rreth procedimeve penale të tyre dhe ecurinë e tyre në raport me qëndrimin e subjektit të rivlerësimit.

2.6 Bazuar në dokumentacionin dhe informacionin e administruar në dosjen hetimore për subjektin e rivlerësimit, konstatohet se shtetasi L.A/K rezultoi me status penal i dënuar për disa vepra penale në shtetin shqiptar dhe në shtetin italian, vepra të cilat bëjnë pjesë në gamën e veprave penale të përcaktuara shprehimisht në pikat 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i përfshirë në krimin e organizuar.

2.7 Nga hetimi rezultoi se shtetasit L.K dhe I.H janë në lidhje gjinie të afërt me njeri-tjetrin, ku shtetasi I.H është djali i dajës së shtetasit L.K, lidhje e cila konfirmohet nga shpjegimet e

³⁵Kthim përgjigje nr. 1 pyetësor nr. 6.

³⁶Shkresa nr. *** prot., datë 10.9.2021 dhe shkresa nr. *** prot., datë 4.10.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë.

subjektit të rivlerësimit, si dhe nga të dhënat të aksesuara nga Komisioni në regjistrin e gjendjes civile³⁷.

2.8 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër informon në lidhje me shtetasin *** se rezultoi, gjithashtu, i kallëzuar në procedimin penal nr. ***, të vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 278 për të cilën nuk është regjistruar emër personi që i atribuohet vepra penale. Kjo çështje³⁸ është në fazën e hetimeve dhe ky procedim penal po hetohet nga subjekti i rivlerësimit.

2.9 Sa më sipër, trupi gjykues çmoi se subjekti, pavarësisht se ka deklaruar njohjen me këtë person, nuk ka deklaruar konfliktin e interesit dhe në kuptim të pikës 1 të nenit 26 të lidhur me nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale “heqja dorë” germa “e” dhe, për pasojë, duhet të kishte hequr dorë.

2.10 Komisioni, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës se:

- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si kontakt të përshtatshëm kontaktet me shtetasin L.K në formularin e deklarimit të kontrollit të figurës;
- subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;
- subjekti ka hetuar çështje penale ku i kallëzuar ka qenë z. L.K në kushtet e konfliktit të interesit.

2.11 Në funksion të barrës së provës subjekti shpjegoi se: *“Lidhur me sa më lart theksoj se në kohën që është plotësuar formulari i pastërtisë së figurës, shtetasi në fjalë, në dijeninë time, nuk ka pasur asnjë procedim penal në Shqipëri dhe në dijeninë time nuk ka qenë ndonjëherë i dyshuar si i përfshirë në organizatat kriminale. Në dijeninë time, as pas kësaj periudhe nuk ka qenë ndonjëherë i përfshirë apo i dyshuar si pjesëtar në organizata kriminale. Detyrimi jonë ka qenë të deklarojmë kontaktet me personat, të cilët në dijeninë tonë, kanë qenë të përfshirë në krimin e organizuar dhe jo çdolloj vepra tjetër penale. Asnjëherë nuk kam qenë në dijeni të faktit që ky person ka qenë i dënuar apo i proceduar në shtetet europiane. Po ashtu, lidhur me këtë konstatim kërkoj të njihem me të gjitha provat (shkresa, foto, video etj.) mbi bazën e të cilave unë jam akuzuar padrejtësisht e madje është cenuar rëndë figura ime, dinjiteti im, morali im, duke e bërë fakt të kryer që unë, sipas burimeve të paspecifikuara të Komisionit, kam bashkëjetuar me këtë shtetas”.*

Qëndrimi i subjektit gjatë seancës dëgjimore

2.12 Subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Unë me kriminelë as bën zoti vaki. Unë kam pasur tërë dosjet e Shkodrës, më të fortët i kam pasur unë. Pyetni kë të doni në Shkodër, unë tashti si merrem unë marr lekët te krimineli. Është, është një nonsens, s’ka logjikë. Atëherë si i mora unë këta vjet, si s’i mora më përpara. Burim the, kush është ky burim, a ka mundësi të më dalë Edlira Cufi përpara e të më thojë, ti zonjë e dashur, ti ke ngrënë, ke pirë, ke ndenj, ke bërë tregti, ku e di unë, ke bërë një marrëzi tjetër me filan fistekun, me filan fistekun. Ku kam, unë kam marrë gjithë Shkodrën në telefon dhe prokuror çfarë bëre, si kalove, a ndenje, a këtej, a kupton. Ku di unë, vetë natyra e punës. 500 oficerë kanë marrë, dikush merrte me numër tjetër, dikush me një tjetër, derisa merrte, u jam fqinja, çfarë bëre, si kalove. Nuk ... telefonat për atë punë i kam që të përgjigjem dhe janë telefona të dyja zyrtare. Nji kjo që kam komunikuar me ju me këtë, në telefon zyrtar si flet me kriminelët ti, me personat që janë ... Po ç’lidhje kam unë tani, ai shoqi atje i dënuar majë Italie, Belgjike a France, ku ishte, unë tani i*

³⁷Sipas regjistrimit të gjendjes civile shtetase M.A (H) nëna e L.K dhe shtetasi M.H, babai i I.H, janë motër e vëlla.

kam kontakt. Çfarë kontakte kam, as telefon, as asnjë gjë në botë. Kontakt është kur kontakton, e merr në telefon, vjen e takon, i jep dorën, e përfaqëson. Ku di unë, kjo është besoj kontakti ...”.

Lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, subjekti parashtroi se: *“Jo, sepse këtë çështje para disa kohëve, nuk e di sa ka qenë viti 2019 a diçka, fundi a fillimi, nuk e mbaj mend, Drejtuesit të Prokurorisë, sepse kjo është një firmë ndërtimi, kanë qenë kushërinjtë e mi ky djali, nipi, kushëri domethënë, djali i xhaxhait tim kanë pasur një firmë ndërtimi bashkë këta të dy dhe kanë qenë për firmën e ndërtimit, diçka e tillë dhe Drejtuesit të Prokurorisë në atë kohë, s’e kujtoj kush ka qenë, ka thënë unë kam, unë kam, kam këtë çështje. Po sa djem kushërinjsh tha kemi pse duhet të heqim dorë, heq dorë larg qoftë, në qoftë se ke një çun xhaxhai, një çun teze, ku di unë, një djalë xhaxhai, një gocë dajë”.*

Vlerësimi i Komisionit

2.13 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve, deklarimeve të subjektit, vlerësimin tërësor të provave të rezultuara nga hetimi, çmon se nuk rezultoi e provuar se:

2.13.1 Shtetasi L.K nuk përfshihet në rrethin e subjekteve, për të cilët subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që të deklaronte, të cilët janë dënuar me një vendim të formës së prerë për një veprë penale, në bazë të ligjit nr. 84/2016. Ai është djali i kumatës së vajzës së hallës së subjektit.

2.13.2 Nuk rezultoi e provuar që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte jorastësore me shtetasin L.K. Lidhjet e krushqisë së subjektit me këtë person rezultuan të provuara dhe, për pasojë, nuk ka të dhëna që kontaktet me këtë person kanë qenë dhe më pas të lindnin detyrimin e subjektit për ta deklaruar në shtojcën e deklaratës *Vetting* si kontakt me një person të papërshtatshëm në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

2.14 Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit duke hetuar një çështje, në të cilën ka qenë i kallëzuar shtetasi L.K, me të cilin ka pasur një lidhje krushqie. Ky konkluzion nuk lidhet me vlerësimin e kontrollit të figurës, por do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit të subjektit.

2.15 Nga verifikimi i sistemit *TIMS* i Policisë së Shtetit, për hyrje-daljet nga territori shqiptar, rezultoi se subjekti ka udhëtuar me djalin e vajzës së xhaxhait³⁹ dhe bashkëshorten e tij, shtetasen K.H, në datën 25.5.2008, me automjetin me targa *** në pronësi të shtetasit R.B/shofer në këtë udhëtim. Nga konsultimi i Komisionit me regjistrin e gjendjes civile rezultoi lidhje në krushqi e subjektit me shtetasin I.H.

2.15.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se ndaj shtetasit I.H, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka dhënë vendimin⁴⁰ e pushimit për veprën penale, e cila përfshihet në veprat penale në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në sa më sipër, Komisioni ngriti dyshime për saktësinë e plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës dhe mosdeklarimin si kontakt të papërshtatshëm me shtetasin I.H.

³⁹Sipas regjistrin të gjendjes civile rezultoi se shtetasi L.M.H është djali i xhaxhait të shtetasit I.M.H. Shtetasit M.H dhe M.H janë vëllezër. Gjithashtu, nga verifikimi në regjistrin e gjendjes civile rezultoi se shtetase H.H nëna e L.H është vajza e xhaxhait të subjektit të rivlerësimit.

⁴⁰Në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes, me kërkesën e datës 25.11.2019, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me “Kërkesë për pushimin e çështjes”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.***, datë 26.12.2019, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, që lidhet me pushimin e procedimit penal nr.***, të vitit 2019, për veprën penale ‘pastrim i produkteve të veprës penale’, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 10.1.2020”. Sipas shënimit në fund të vendimit konstatohet se vendimi nr.***, datë 26.12.2019, ka marrë formë të prerë në datën 10.1.2020.

2.15.2 Nga hetimi rezultoi e provuar se⁴¹ nga verifikimet e bëra në regjistrat elektronikë, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar çështje të regjistruara në ngarkim të shtetasit I.H.

2.16 Trupi gjykues, në përfundim të hetimit, i dërgoi subjektit barrën e provës duke ngritur pretendimin për detyrim të subjektit për të deklaruar z. I.H si kontakt të papërshtatshëm.

2.17 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, parashtrroi se: *“Shtetasin në fjalë nuk e kam pasur kurrë në hetim dhe në dijeninë time nuk ka qenë kurrë i dyshuar si i përfshirë në krimin e organizuar. Po ashtu, edhe lidhur me këtë rast, kërkoj të njihem me të gjitha provat ku bazohet dyshimi/konkluzioni juaj lidhur me përfshirjen time në akte korruptive me personin në fjalë, kur unë kam mbi 10 vjet që nuk kam asnjë lloj komunikimi, fizik apo elektronik, me këtë shtetas. Për sa kohë unë po akuzohem në mënyrë të padrejtë, e rrjedhimisht, vendimi juaj është analog me një vendim gjykatë/fajësie, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, kërkoj të njihem me të gjitha provat në të cilat bazohen këto aludime”.*

Vlerësimi i Komisionit

2.18 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve, deklarimeve të subjektit dhe vlerësimit tërësor të provave të rezultuara nga hetimi, çmon se nuk rezultoi e provuar se:

2.18.1 Shtetasi I.H është djali i kunatit të vajzës së xhaxhait të subjektit dhe, për pasojë, nuk është në rrethin e subjekteve për të cilët ekzistonte detyrimi për deklarim në bazë të ligjit nr. 84/2016. Në shtojcën e deklaratës së kontrollit të figurës, me termin “anëtar familjeje” do të kuptohet bashkëshortja/bashkëshorti i tij, i afërti deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë, personi i lidhur me detyrime birësimi ose që bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët.

2.18.2 Nuk rezultoi e provuar që subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte jorastësore me shtetasin I.H. Nuk rezultoi e provuar se kontaktet me këtë person kanë qenë jashtë kontakteve për shkak të lidhjes së tyre të krushqisë dhe, për pasojë, të linin detyrimin e subjektit për të deklaruar në shtojcën e deklaratës *Vetting* si kontakt me një person të papërshtatshëm, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Opinionit i vëzhguesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit

2.19 Në funksion të hetimit të figurës për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit⁴² ka paraqitur opinionin e tij lidhur me shtetasin A.H, pronari i automjetit me targa ***, i marrë në përdorim në vitin 2012 dhe blerë në vitin 2019 nga subjekti i rivlerësimit.

2.20 Në opinion janë parashtruar veprat penale për të cilat ishte dënuar në shtetin italian shtetasi A.H a N.H, të cilat bëjnë pjesë në gamën e veprave penale të parashikuara në pikat 8 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave personi cilësohet si i person i përfshirë në krimin e organizuar.

2.21 Komisioni administroi gjetjen e paraqitur, sipas pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016. Në gjetjen e tij, vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit konkludon dhe rekomandon⁴³ për të vlerësuar si:

⁴¹Shkresë nr.*** prot., datë 18.11.2021.

⁴²Shkresë nr.*** prot., datë 7.1.2022.

⁴³Përkufizimi ligjor i veprave penale për të cilat z. A.H është dënuar në Itali, sipas pikës a) deri g) (siç parashikohet nga neni 73 i aktit legjislativ Italian 309/1990 kryqëzohet me përkufizimin ligjor në nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Prandaj, sjellja për të cilën subjekti i rivlerësimit është dënuar në Itali (transport, mbajtje për shitje, import, shitje e lëndëve narkotike) dhe 283/a (import i lëndëve narkotike). Këto vepra penale bien brenda listës së nenit 3 pika c) e ligjit 10192/2009, i cili referohet edhe në nenin 3, pika 15 e ligjit për rivlerësimit kalimtar, që e përkufizon

- a) plotësinë e deklaratës për kontrollin e figurës, si dhe ekzistencën e kontakteve direkte/indirekte të subjekteve të rivlerësimit me personat e përfshirë në krimin e organizuar;
- b) përshtatshmërinë etike të sjelljes së subjektit të rivlerësimit që konsiston në marrjen në përdorim të automjetit në pronësi të një personi të përfshirë në krimin e organizuar.

2.21.1 Komisioni mori në konsideratë opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të Monitorimit gjatë hetimit të figurës për subjektin e rivlerësimit, sipas të cilit shtetasi A.H a N.H rezultoi i dënuar në shtetin italian, për efekt të vlerësimit të kriterit të pastërtisë së figurës.

2.21.2 Nga sa më lart, bazuar në informacionet e administruara në zbatim të nenit 36 të ligjit nr. 84/2016, si edhe në opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të Monitorimit, të pranuar nga Komisioni, në raport edhe me nenin 34 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi A.H a N.H, për efekt të ligjit nr. 84/2016, është person i përfshirë në krimin e organizuar dhe konsiderohet kontakt i papërshtatshëm i subjektit, fakt të cilin subjekti kishte detyrimin që ta deklaronte në deklaratën për kontrollin e figurës. Rrethanat e rezultuara që janë marrë parasysh në këtë konstatim, evidentojnë konstatimin e faktit për kontakt të papërshtatshëm. Rezultoni e provuar se nga ky shtetas subjekti ka përdorur pa kundërshtim për një periudhë 7-vjeçare automjetin e analizuar më sipër.

2.21.3 Sa më sipër, verifikimi i pastërtisë së figurës për subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi u mbështet në:

- identifikimin e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës;
- vërtetësinë e deklaratimit në deklaratën e kontrollit të figurës.

Për sa u arsyetua më lart, Komisioni konstaton se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me kontrollin e figurës në formularin sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016. Ky rezultat hetimi bazohet gjithashtu edhe në informacionet dhe dokumentacionet e klasifikuara, të cilat nuk mund të përdoren në aktet publike apo të vihen në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, me përjashtim të pjesëve të deklasifikuara, për sa kohë është ligjëruar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁴⁴.

2.22 Në përfundim të hetimit, Komisioni, në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës pasi nga hetimi rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në bazë të germave “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 38 dhe pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë duke mosdeklaruar kontaktet me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

katëgorinë e “personave të përfshirë në krimin e organizuar”. A.H duhet, për këtë arsye, të cilësohet si “person i përfshirë në krimin e organizuar”, siç përkufizohet nga neni 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Z. A.H i lindur në Shqipëri më 2.1.1978, është pronari i automjetit i cili gjatë vitit 2012 i është dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit, me anën e ndërmjetësimit të z. A.H (i njohur ndryshe si B.LI). Asnjë shpërblim financiar nuk i është dhënë nga ana e subjektit të rivlerësimit z. A.H për përdorimin e këtij automjeti, pas 7 vitesh, subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin me çmim 2.000 euro.

⁴⁴Në vendimin e datës 19.9.2017, në çështjen nr. 35289/11, Ragner c/ Republikës Çeke14, është shprehur: “... dhoma konkludoi se arsyet për vendimin e mospasjes akses (moszbulimit) të dokumentit në fjalë nga ana e kërkuesit ishin bazuar në interesa të sigurisë kombëtare, sepse sipas autoriteteve, zbulimi mund të kishte pasur efektin e zbulimit të metodave të punës së shërbimit të inteligjencës dhe burimet e tij të informacionit ose mund të çonin në përpjekjet e kërkuesit për të ndikuar mbi dëshmitarët e mundshëm. Sipas Dhomës, procedura e vendimmarrjes plotësonte ‘aq sa ishte e mundur’ kërkesat e procesit të drejtë dhe me ballafaqim dhe barazisë së armëve në proces dhe përfshinte mbrojtje të përshtatshme të të drejtave dhe interesave të aplikantit, dhe kështu nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës ...”.

2.23 Në funksion të barrës së provës, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi: *“Lidhur me sa më lart, sikurse e shpjegova edhe në përgjigjet e dhëna më sipër, e kundërshtoj me forcë këtë pretendim dhe kërkoj të njihem me provat që më implikojnë mua, duke më akuzuar padrejtësisht për kontakte, përfshirje me persona të përfshirë në krimin e organizuar. As nuk kam pasur as nuk kam dijeni edhe sot që ky person të jetë i dënuar sipas materialeve të paraqitura nga ana juaj. Unë personalisht asnjë prej këtyre shtetasve nuk e kam pasur as nuk e kam në procedim, hetim apo gjykim. Unë nuk kam bërë me dijeninë time kurrë deklaram të pasaktë lidhur me këta persona, deklarimi im është bërë në përputhje me kriteret e formularëve përkatës që kemi pasur për detyrim të plotësojmë”*.

Qëndrimi i subjektit në seancë dëgjimore

2.24 Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës, mbajti të njëjtin qëndrim, si edhe në parashtrimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Vlerësimi Komisionit

2.25 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve, deklarameve të subjektit dhe vlerësimit tërësor të provave të rezultuara nga hetimi, çmon se nuk rezultoi e provuar dijenia e subjektit për dënimin penal të z. A.H, pronarit të automjetit të përdorur prej saj dhe, për pasojë, nuk konstatoi mangësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, si dhe ekzistencën e kontakteve direkte/indirekte të subjektit të rivlerësimit me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

2.26 Trupi gjykues çmon se në rastin konkret gjendet para papërshtatshmërisë etike të sjelljes së subjektit të rivlerësimit që konsiston në marrjen në përdorim të automjetit në pronësi të një personi të përfshirë në krimin e organizuar.

Të dhënat nga sistemi TIMS

2.27 Nga hetimi⁴⁵ rezultoi e provuar se disa prej shtetasve me të cilët subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit janë me precedentë penalë.

2.28 Në vijim të hetimit, Komisioni i drejtoi pyetje subjektit të rivlerësimit, si vijon:

Në pronësi të kujt kanë qenë automjetet më të cilat keni udhëtuar dhe subjekti përgjigjet se: *“Duke qenë se është një periudhë e gjatë për të cilin kërkohet informacion, nuk mund të kujtoj detaje specifike, por di t’ju sqarojë një fakt që zakonisht kam udhëtime drejt familjarëve të mi jashtë shtetit, të cilat janë bërë me linja ajrore, kam bërë udhëtime me kolektivin e punës dhe këto udhëtime kanë qenë të organizuara po me shoqëri turistike, ndërsa daljet jashtë shtetit kryesisht në Mal të Zi i kam bërë me mjete të rastit, drejtuesit apo pronarët e të cilëve nuk i njoh. Një rast që kujtoj kam lëvizur me djalin e shtetasit A.D, i cili është punonjës policie dhe koleg prej vitesh, shtetasin F.D, me mjetin privat të tij, të cilit s’ia di targën dhe ka qenë rreth muajit gusht të vitit 2019”*.

Cila është lidhja juaj me këta persona dhe a keni hetuar ju kallëzime dhe/ose procedime penale ku personat që kanë qenë pronar/përdorues të automjeteve kanë qenë kallëzues/viktima/ të dëmtuar apo të kallëzuar, të dënuar, persona në hetim apo të pandehur dhe subjekti përgjigjet se: *“Shtetasi F.D me të cilin unë sqarova se kam udhëtuar një herë para disa vitesh në (gusht të vitit 2019) i ka pas humbur një telefon dhe çështjen në fjalë e kam ndjekur unë sipas shortit. Ky shtetas ka pasur statusin e të dëmtuarit kallëzues dhe çështja është pezulluar”*.

⁴⁵Shkresë nr.*** prot., datë 16.12.2021,e Prokurorisë së Rrethit Shkodër.

Cila është lidhja juaj me personat me të cilët keni udhëtuar së bashku dhe a keni hetuar ju kallëzime dhe/ose procedime penale ku personat që kanë qenë pronar/përdorues të automjeteve kanë qenë kallëzues/viktima/ të dëmtuar apo të kallëzuar, të dënuar, persona në hetim apo të pandehur dhe subjekti përgjigjet se: *“Nuk jam në dijeni nëse ndonjëri nga këta shtetas janë për ndjekje penale nga unë dhe nuk arrij të specifikoj nëse unë kam pasur ndonjë kontakt të veçantë me shtetasit në fjalë”.*

Në dijeninë tuaj a është ndonjëri prej tyre i ndjekur penalisht ose i dënuar dhe nëse po për çfarë vepre penale? Subjekti përgjigjet se: *“Kësaj pyetjeje mendoj se i jam përgjigjur në pikën a, pasi unë nuk i njoh personat me të cilët kam udhëtuar dhe nuk mund të them nëse kanë qenë apo jo në ndjekje penale apo të dënuar”.*

2.28.1 Në vijim të përgjigjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioni iu drejtua Prokurorisë Shkodër për aktet procedurale penale të kallëzimit penal me të dëmtuar akuzuesin F.D, për hetimet e të cilit deklarohet nga subjekti se i ka ndjekur ajo.

2.28.2 Nga hetimi rezultoi se⁴⁶subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore në lidhje me shtetasin F.D, në pozitën procedurale si i dëmtuar akuzues për procedimin penal nr.***, viti 2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal. Çështja është pezulluar dhe dosja është dërguar në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër për vijim të hetimeve për zbulimin e autorit të veprës penale.

2.28.3 Nga hetimi i Komisionit dhe verifikimit të të dhënave të përcjella nga Policia e Shtetit nga sistemi TIMS rezulton se për subjektin e rivlerësimit ka raportime për hyrje-dalje nga territori shqiptar me shtetasit F dhe E.D, në datën 31.8.2019, me automjetin që sipas AMF online rezulton në pronësi të shtetasit F A.D.

2.28.4 Nga hetimi rezultoi e provuar se subjekti në hetimin e kallëzimit të shtetasit F.D ka ushtruar funksionet në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”* neni 5 *“Interesat Private”* pika 1 në të cilin përcaktohet se: *“Interesat private të zyrtarit janë ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhënie të njohura të miqësisë apo të armiqësisë”.*

Vlerësimi i Komisionit

2.29 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve, deklarimeve të subjektit dhe vlerësimit tërësor të provave të rezultuara nga hetimi, çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në hetimin e çështjes me të dëmtuar akuzues shtetasin F.D. Ky konkluzion do të vlerësohet në rezultatin përfundimtar të procedurës së rivlerësimit.

2.30 Trupi gjykues çmon se është në përgjegjësinë e subjekteve të rivlerësimit të tregojnë kujdesin e shtuar për të evituar marrëdhënie të tilla nëpërmjet përdorimit të automjeteve në pronësi të personave me precedentë penalë. Deklarimi nga subjekti se ajo nuk i ka njohur pronarët e automjeteve me të cilët ka udhëtuar, pasi kanë qenë automjete të rastit, tregojnë mungesë të kujdesit të kontakteve nga subjekti me persona me precedent penal, qoftë dhe në rastet kur këta të fundit nuk përfshihen në rrethin e veprave penale të përcaktuara nga pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Përdorimi nga subjekti i këtyre automjeteve konsiderohet si veprim që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016⁴⁷.

❖ KALLËZIMET PENALE NË NGARKIM TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

⁴⁶Kthim përgjigje nr.*** prot., datë 19.11.2021 e Prokurorisës Rrethit Shkodër.

⁴⁷Vendimi nr. ***, datë 4.8.2021, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Nga hetimi ka rezultuar se⁴⁸ ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr.***, i vitit 2015 dhe kallëzimi penal nr.***, i vitit 2009.

1. Kallëzimi penal nr.***

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka administruar materialin referues nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr.*** prot., datë 27.11.2015, e cila ka regjistruar procedimin penal nr.***, të vitit 2015, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, “shpërdorim detyre”. Procedimi penal është regjistruar pasi shtetasi N.M ka depozituar kallëzim penal për veprën penale “shpërdorim detyre” në datën 16.11.2015, lidhur me veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit në hetimin e kallëzimit të tij.

Nga hetimi rezultoi se në datën 29.1.2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar kallëzimin penal nr.*** në ngarkim të shtetasit Z.H, me detyrë kryetar i Komunës *** dhe sekretare e zyrës së urbanistikës shtetasit A.M për veprën penale “shpërdorim detyre”⁴⁹. Veprimet hetimore të kallëzimit janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, e cila me vendimin e datës 10.2.2008, në cilësinë e prokurores së çështjes ka vendosur “*Mosfillimin e procedimit penal*”. Ndaj vendimit të mosfillimit, shtetasi N.M është ankuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr.***, datë 10.10.2008, ka vendosur “*Shfuqizimin e vendimit të mosfillimit duke detyruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër të vijojë hetimet për kallëzimin penal nr.***, datë 29.01.2008*”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 21.10.2008. Gjykata, në vendimmarrjen e saj, ka arsyetuar ndër të tjera se *vendimi i prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal të datës 10.2.2008 për kallëzimin penal nr.*** është i pabazuar në ligj e në prova dhe kërkesa e paraqitur nga shtetasi N.M duhet pranuar, pasi evidentohen elemente të veprës penale ‘shpërdorim detyre’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*

Në vijimësi të urdhërimeve të gjykatës për kryerjen e veprimeve hetimore të lëna nga gjykata, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurores së çështjes më 11.11.2008, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr.***, për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal pa emër autori. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, me vendim të datës 26.11.2009, ka vendosur “*Pushimin e hetimeve*”. Ndaj vendimit të pushimit të hetimeve të këtij procedimi ka ushtruar ankim shtetasi N.M në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr.***, datë 26.4.2010, ka vendosur “*rrëzimin e kërkesës së kërkuetit N.M*”. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit shtetasi N.M, e cila ka vendosur “*Ndryshimin e vendimit nr.***, datë 26.4.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke shfuqizuar vendimin e pushimit dhe vazhdimin e hetimeve për procedimin penal nr.***, të vitit 2008*”.

Pas kthimit nga Gjykata e Apelit Shkodër për vijimin e hetimeve të procedimit penal nr.*** të vitit 2008 subjekti i rivlerësimit ka vijuar hetimet dhe në përfundim me vendim të datës 20.5.2012 ka vendosur “*Pushimin e hetimeve bazuar në germën ‘c’, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 66 të Kodit Penal*”. Ndaj vendimit të pushimit të hetimeve të datës 20.5.2012 shtetasi N.M ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr.***, datë 28.10.2013, ka vendosur “*Pranimin e kërkesës së kërkuetit duke urdhëruar një subjekt tjetër rivlerësimi të bëjë cilësimin e duhur të veprës*

⁴⁸Shkresë nr.*** prot., datë 18.5.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme.

⁴⁹Objekt i këtij kallëzimi penal ka qenë leja e ndërtimit e nxjerrë nga Komuna *** Shkodër në favor të shtetasit N.Rr, për ndërtimin e një kompleksi derrash në fshatin ***. Kallëzuesi ka pretenduar se leja është dhënë në kundërshtim me ligjin dhe është cenuar gëzimi i pronës së tij, si dhe është bërë e pamundur për shkak të ndotjes së ajrit të jetohet në atë vend.

penale dhe të marrë si të pandehur persona ndaj të cilëve është bërë kallëzim për shpërdorim detyre të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal". Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila me vendimin nr. ***, datë 27.3.2014, ka vendosur *"Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 28.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër duke rrëzuar kështu edhe pretendimet e ankuesit N.M"*.

Ndaj vendimit nr. ***, datë 27.3.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka ushtruar ankim në Gjykatën e Lartë shtetasi N.M, e cila me vendimin nr. ***, datë 15.1.2015, ka vendosur *"Mospranimin e rekursit të ushtruar ndaj vendimit nr. ***, datë 27.3.2014, të Gjykatës së Apelit"*.

Sa më sipër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në kuadër të verifikimit të rrethanave të kallëzimit të shtetasit N.M mbi pretendimet e tij për subjektin e rivlerësimit dhe veprimeve hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procedimin nr. ***, të vitit 2008, ka konkluduar se nga subjekti i rivlerësimit si prokurore e çështjes janë zbatuar afatet procedurale të hetimit. Pretendimet e kallëzuesit për zvarritje të hetimeve nuk qëndrojnë pasi janë kryer veprime hetimore në mënyrë të vazhdueshme dhe janë marrë vendime, që në çdo rast janë ankimuar nga kallëzuesi. Në përfundim të hetimeve me vendimin e datës 29.1.2016, Prokuroria Lezhë ka vendosur *"mosfillimin e procedimit penal ndaj subjektit të rivlerësimit"*. Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë shtetasi N.M. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.***, datë 22.6.2016, ka vendosur *"lënien në fuqi të vendimit datë 29.1.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë për mosfillimin e procedimit penal nr.***, viti 2015"*. Kundër vendimit nr.***, datë 22.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër z. N.M. Referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë www.gjykataelarte.gov.al çështja është aktualisht duke u gjykuar pranë kësaj gjykate.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se mangësitë e konstatuara në mënyrë të përsëritur nga gjykata për hetimin e kryer nga subjekti janë të bazuara. Natyrisht, një konstatim i tillë do të vlerësohet dhe në raport me gjetjet e tjerat të trupit gjykues dhe në veçanti për vlerësimin e kriterit profesional.

Trupi gjykues çmon se bazueshmëria në prova dhe në ligj e veprimtarisë së prokurorit mund t'i nënshtrohet vetëm kontrollit gjyqësor. Pretendimi se me veprimet e tij subjekti ka kryer shpërdorim detyre është hetuar dhe i është nënshtuar kontrollit gjyqësor dhe, për pasojë, nuk rezultoi e provuar. Në kuptim të pikave 3 dhe 4, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, kallëzimi nuk përmban elemente të vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

2. Kallëzim penal nr. ***

Prokuroria e Përgjithshme, në datën 18.12.2008, ka regjistruar ankimin e të dënuarit R.R lidhur me vendimin e Gjykatës Ushtarake Shkodër dhe Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Në ankimin e depozituar, shtetasi R.R i dënuar, kallëzon disa subjekte rivlerësimi përfshi edhe subjektin e rivlerësimit, pasi pretendon se ka kryer falsifikimin e procesverbalit të deklarimeve të tij si i pandehur gjatë fazës së hetimit paraprak të procedimit penal në ngarkim të tij. Në kallëzimin e tij shtetasi R.R deklaroi se është falsifikuar firma e tij nga subjekti i rivlerësimit, si dhe është dërguar dosja e tij penale pa firmën e tij në Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë. Shtetasi R.R është arrestuar në flagrancë për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/ dh -22 ndaj një efektivit të RENEA-s në momentet e kapjes së tij dhe nenit 278/2 të Kodit Penal i arrestuari ka nënshkruar në fund të procesverbalit se *nuk*

*është dakord me procesverbalin e arrestimit. Shtetasi R.R është marrë si i pandehur dhe vendimi i njoftimit të akuzës datë 28.9.2013, përpiluar nga subjekti i rivlerësimit, i është njoftuar të pandehurit, i cili ka nënshkruar në fund të vendimit se *pranon vetëm armëmbajtje pa leje*, akuzë të cilën e pranon në procesverbalin e pyetjes së tij me cilësinë e të pandehurit duke mos qenë dakord me akuzën “tentativë vrasjeje” të punonjësit të RENEA-s. Procedimi penal në fjalë nr. ***, i vitit 2004, i Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë është dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, e cila me vendimin nr. ***⁵⁰, datë 13.10.2004, ka vendosur “*deklarimin fajtor të të pandehurit R.R për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/c /dh-22 ,278/2/3 dhe dënimin e tij në përfundim me 20 vjet burgim*”.*

Në vijim të hetimit në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë kallëzimin penal të të dënuarit R.R. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka regjistruar çështjen penale nr. ***, të vitit 2009, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Nga studimi i akteve penale rezulton se ndaj shtetasit R.R është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 28.9.2003, për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/c-22 të Kodit Penal, të cilat është hetuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda⁵¹. Prokuroria Lezhë, me qëllim verifikimin e thënieve të të dënuarit R.R, ka administruar kopje të procedimeve penale nr. ***, datë 2004, të Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë dhe aktet e procedimit penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu, në lidhje me këtë çështje, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka marrë pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë kopjen e ankimit të bërë nga i pandehur dhe avokati mbrojtës i tij drejtuar Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda. Prokuroria Lezhë referon se në ankimin e tij në asnjë moment nuk bëhet kërkesë si ndaj veprimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe përfaqësuesve të tij, si dhe ndaj Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë dhe përfaqësuesve të tyre, të cilat kanë bërë shtesë të akuzës së ngritur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu, edhe përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor nuk është ngritur asnjë pretendim për pavlefshmëri aktesh, por është kërkuar gjykim i shkurtuar i çështjes, pra zgjidhja e saj në gjendjen në të cilën janë aktet. Ndërkohë, në ankimin e bërë shprehen vetëm për faktin që nuk gjenden para elementëve të veprës penale sipas nenit 79/c-22 të Kodit Penal. Në përfundim, Prokuroria e Rrethit Lezhë ka konkluduar se ekzistojnë rrethana që nuk bëjnë të mundur fillimin e procedimit penal të parashikuar nga neni 290/1 germa “c” të Kodit të Procedurës Penale fakti nuk ekziston dhe mbështetur në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Referuar sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore www.gjykata.gov.al nuk rezulton të jetë ankimuar vendimi i mosfillimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se bazueshmëria në prova dhe në ligj e veprimtarisë së prokurorit mund t'i nënshtrohet vetëm kontrollit gjyqësor. Pretendimi se me veprimet e tij subjekti ka kryer shpërdorim detyre është hetuar dhe i është nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe, për pasojë, nuk rezultoi e provuar. Në kuptim të pikave 3 dhe 4, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, kallëzimi nuk përmban elemente të vlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

Ankesa pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë

⁵⁰Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë e cila me vendimin nr.*** datë 13.12.2004 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të lartpërmendur duke pushuar çështjen vetëm për akuzën e 278/3 të Kodit Penal. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë i pandehuri e cila me vendimin nr.*** datë 28.05.2005 ka vendosur mospranimin e rekursit.

⁵¹Në lidhje me këtë çështje nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër u shpall moskompetenca dhe procedimi penal në fjalë i kaloi Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë.

Nga hetimi rezultoi se informacioni i paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit rezultoi të jetë në proces shqyrtimi në kuadër të inspektimit tematik të miratuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me urdhrin nr. ***, datë 15.6.2021, “Për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me objekt “Respektimi i kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve shpërthyesë dhe municionit”.

Lidhur me subjektin e rivlerësimit objekt ka qenë vendimi nr. ***, datë 5.6.2021, me objekt “vlerësimi i ligjshëm i arrestit të bërë nga policia gjyqësore në datën 2.6.2021 të shtetasit H.N për veprën penale ‘mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve shpërthyesë dhe municionit’, të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Caktimi ndaj tij të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal dhe garanci pasurore në shumën 500.000 lekë, parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale.

Në përmbajtje të këtij vendimi konstatohet se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes ka kërkuar vlerësimin e ligjshëm të arrestit të bërë nga policia gjyqësore në datën 2.6.2021, të shtetasit H.N për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve shpërthyesë dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit Penal dhe garanci pasurore, në shumën 500,000 lekë, parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale.

Sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime rreth analizës së rrethanave dhe fakteve të vlerësuara sipas Kodit të Procedurës Penale, në vendosjen e kësaj mase sigurimi.

2.45 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon se: *“Kërkesa ime për masë sigurimi ka qenë në përputhje me ligjin. Ankesa e z. A.V, e cila është mbështetur edhe nga mediat (B. C), në vlerësimin tim është një qëndrim politik. Siç është cituar dhe nga ana juaj përgjatë këtij raporti, vendimet e prokurorit vlerësohen nga gjykatat. Po ashtu, më duket e padrejtë përfshirja në raportin e vlerësimit i këtij rasti, i cili shtrihet përtej periudhës së rivlerësimit”.*

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se pretendimet e ngritura në ankesën drejtuar ILD-së janë problematika që nuk lidhen me objektin e ligjit nr. 84/2016, por kanë të bëjnë me vlerësimin e themelit nga prokurori, të cilat janë objekt vetëm i kontrollit gjyqësor.

Vlerësimi i Komisionit për kriterin e kontrollit të figurës

Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve, deklarimeve të subjektit dhe vlerësimit tërësor të provave të rezultuara nga hetimi çmon se:

- Subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrimin për të deklaruar në deklaratën *Vetting* personat me lidhje krushqie, të cilët nuk janë në rrethin e subjekteve “krushqi deri në shkallë të dytë”, të parashikuara në ligjin nr. 84/2016.
- Nuk rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Subjekti duhet të kishte treguar kujdes të shtuar për personat me të cilët ka udhëtuar jashtë vendit me qëllim garantimin e besimit të publikut dhe shmangien e kontakteve me persona me precedent penalë.
- Përdorimi nga subjekti pa shpërblim të një automjeti në pronësi të një personi të përfshirë më krimin e organizuar është një shkelje etike e rëndë, e cila do të vlerësohet së bashku

me konkluzionet e nxjerra gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, por nuk rezultoi e provuar dijenia dhe kontakti i drejtpërdrejtë i subjektit të rivlerësimit me të.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë vlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Edlira Cufi, bazuar në raportin për vlerësimin e aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit dhe aktet bashkëlidhur tij, dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2021. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka analizuar të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

❖ GJETJET NGA FORMULARI I VETËVLERËSIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 6.7.1995, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar prokurore në Malësinë e Madhe. Nga viti 1998 dhe aktualisht ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për sa i përket të dhënave statistikore, subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar gjithsej 561 (pesëqind e gjashtëdhjetë e një) çështje. Në raportin e Komisionit të vlerësimit pranë KLP-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar në nivele të mira në aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi, me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, është vlerësuar për punën e kryer për aftësitë profesionale dhe etike për vitet 2014 - 2016, me “shumë mirë”.

Subjekti i rivlerësimit Edlira Cufi ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore:

- i. kërkesë “për gjykimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- ii. vendim “për pushimin e procedimit e hetimeve në procedimin penal nr. *** të vitit 2014”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- iii. vendim “për lejimin e përgjimit ambiantal për procedimin penal nr. ***, të vitit 2016”, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti, dokumenti është i strukturuar në tri pjesë, të cilat janë: pjesa hyrëse; pjesa përshkruese/arsyetuese; si dhe pjesa konkluduese. Akti paraqitet i strukturuar dhe i shkruar në një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore. Konstatohet se në akt nuk përdoren gjerat “ë” dhe “ç”. Në akt paraqiten rrethanat e faktit. Teksti përmban referenca ligjore, ku citohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, por nuk vijohet me analizimin e tyre apo të kushteve që plotësohen në rastin konkret për lejimin e përgjimit, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 221 dhe germave “b” dhe “c” të pikës 3. Baza ligjore, ku janë mbështetur kërkesat e prokurorit, është identifikuar drejt. Pjesa disponuese është në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 222, të Kodit të Procedurës Penale. Akti mban datën dhe nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes.

Komisioni vëren se nga analiza e kryer për këto tri dokumente ligjore, si nga Grupi i Punës pranë KLP-së, ashtu edhe nga Komisioni, nuk u konstatuan problematika që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit.

❖ PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE PENALE DHE DOKUMENTEVE LIGJORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Subjekti i rivlerësimit rezulton se për periudhën e rivlerësimit ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga shorti i hedhur u përzgjedhën në mënyrë rastësore dy vendime për mosfillimin e procedimit penal, një vendim pushimi dhe dy vendime për dërgimin e çështjes në gjyq të kësaj prokurorie, si vijon:

- dokumenti ligjor – vendim “për mosfillimin e procedimit penal”, datë 3.6.2015, për kallëzimin penal nr. ***, datë 13.5.2015, për veprën penale “prerje e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal;
- dosja 2 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 6.5.2014, për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143, paragrafi 1 i Kodit Penal;
- dosja 3 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 25.4.2014, për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143, paragrafi 1 i Kodit Penal;
- dokumenti ligjor – vendim “për pushimin e hetimeve në procedimin penal nr. *** të vitit 2014”, datë 3.7.2014, përpiluar nga subjekti i rivlerësimit;
- dosja 4 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 2.2.2016, për veprat penale “dhunë në familje” dhe “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, parashikuar përkatësisht nga nenet 130/a/1 dhe 320 të Kodit Penal;
- dosja 5 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 21.2.2016, në ngarkim të shtetasit N.V, akuzuar për veprën penale “vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal.

Vlerësimi i Komisionit

Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar elementet e veprës penale, objekt hetimi. Subjekti i rivlerësimit ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit. Komisioni konstaton se në aktin e diskutimit përfundimtar janë respektuar kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, të parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal, që ka të bëjë me mënyrën e caktimit të tij. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit, në dokumentet 1, 2 dhe 3 dhe në dosjet 4 dhe 5 ka analizuar rrezikshmërinë e autorit, rrezikshmërinë e veprës penale, si dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale në funksion të masës së dënimit të kërkuar. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

❖ TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallëve të para, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Edlira Cufi:

- i. Me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe të Shërbimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, është dhënë informacioni se nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë disiplinore për periudhën 2006 – 2019.
- ii. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta. Nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së saj në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).
- iii. Ka dy materiale hetimore, konkretisht, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 13.1.2020, është kthyer përgjigjja se nga verifikimet e mundshme të kryera në regjistrat fizikë të procedimeve penale të kësaj prokurorie, në arkivin e prokurorisë gjenden fashikujt e kallëzimeve penale nr. *** të vitit 2009 dhe nr. *** të viti 2016, kallëzime të cilat janë përcjellë në Komision edhe nga Prokuroria e Përgjithshme.

Për këto dy kallëzime është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Këto kallëzime dhe vendimet e mosfillimit janë trajtuar në vijim në kontrollin e figurës.

Spektori i protokoll - arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2020, bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2019 rezulton se pranë sektorit të protokoll - arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme është identifikuar praktika nr. *** prot. e vitit 2014, që ka të bëjë me ankesën e shtetasit Rr.Q, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj subjektit të rivlerësimit.

Ankuesi Rr.Q ka pretenduar se vëllai i tij Gj.B është dhunuar fizikisht nga oficeri i policisë gjyqësore A.H, që e ushtron këtë detyrë në Malësinë e Madhe. Prokurorja e çështjes Edlira Cufi nuk e ka thirrur ankuesin për t'i marrë deklaramë, pasi sipas tij *korruptioni ka arritur deri në kulm*. Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Inspektimit dhe e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga komunikimi që kanë pasur me ankuesin Gj.B ka rezultuar se ai ishte pyetur në cilësinë e deklaruesit në datën 12.5.2014. Nga korrespondenca me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Gj.B, në datën 6.3.2014 prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 13.6.2014, për veprën penale “kryerje e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Në këto kushte, kur me ankuesin është biseduar në telefon, është vendosur të mos kthehet përgjigje dhe praktika të arshivohet dhe qëndrimet e prokurorit përgjithësisht janë mbështetur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

C.1 RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumente ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Pas verifikimit të raportit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur

me vlerësimin profesional.

Përgjatë hetimit Komisioni konstatoi disa çështje dhe gjetje të tjera lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

Komisioni kreu hetimin administrativ pranë organeve ligjzbatuese e verifikuese dhe kërkoi informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit. Në vijim të hetimit, bazuar në raportin e DSIK-së, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁵² lidhur me disa dosje/procedime penale në ngarkim të shtetasve ndaj të cilave dyshohej kryerja e veprimeve hetimore favorizuese ndaj tyre, si dhe ndikimi i paligjshëm i subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për informacion dhe dokumentacion, e cila bën me dije se verifikimi i informacionit u realizua në tri periudha dhe u përpunuan dosjet gjyqësore, ku prokurore në gjykim ka qenë Edlira Cufi. Komisioni administroi dhe hetoi dosjet gjyqësore, si në vijim.

Dosja penale në ngarkim të shtetasit E.P⁵³

Nga rrethanat e ngjarjes dhe faktet penale të përcjella me fashikullin penal rezultoi se shtetasi E.P, në datën 8.3.2016, në afërsi të hotel “****”, Shkodër, ka goditur me shkelma dhe grushte shtetasin E.S dhe i ka marrë 300 euro, 60.000 lekë, pasaportën biometrike, kartën e identitetit dhe një aparat të markës “****”. Në këto rrethana, policia gjyqësore në datën 8.3.2016 ka bërë kapjen në flagrancë të shtetasit E.P, i dyshuar për veprën penale “vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Bazuar në materialin kallëzues, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 8.3.2016. Pas regjistrimit, me ndjekjen e veprimeve hetimore është caktuar subjekti i rivlerësimit. Në cilësinë e prokurores së çështjes⁵⁴, subjekti i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesën për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” ndaj shtetasit E.P, si i dyshuar për veprën penale “vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Në kërkesë, subjekti ka kërkuar të vleftësohet si i ligjshëm arrestimi për shtetasin E.P, i arrestuar në datën 8.3.2016, ora 11:00, për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “arrest me burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Në kërkesën, datë 8.3.2016, të vleftësimit si të ligjshëm të arrestimit të shtetasit E.P, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka përcaktuar nëse masa e sigurimit personal “arrest me burg” ndaj të dyshuarit është me apo pa afat.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë 10.3.2016, ka vendosur:

- vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të kryer ndaj shtetasit E.P, të arrestuar në datën 8.3.2016, ora 11:00;
- caktimin ndaj të dyshuarit E.P për veprën penale “vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, masën e sigurimit “arrest me burg”, me afat 10 ditë, të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.

⁵²Shihni shkresën nr.*** prot., datë 6.10.2021.

⁵³Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndaj shtetasit E.P, ka vënë në dispozicion edhe dy vendime penale⁵³ të tjera. Në vendimin nr.***, datë 21.5.2012 dhe vendimin nr.***, datë 21.5.2012, rezultoi se veprimet hetimore të procedimit penal nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit.

⁵⁴a) Procesverbal i arrestimit në flagrancë; b) deklaratim e personit nën hetim; c) raport shërbimit të policisë; ç) sekuestrimi i provave materiale; dhe d) kallëzimi.

Komisioni, me qëllim vlerësimin me objektivitet të vlerësimit të veprimtarisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi dhe analizoi aktet e procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit E.P.

Nga studimi i akteve të procedimit penal, si dhe referuar përmbajtjes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes lidhur me caktimin me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit dhe për vleftësimin e arrestit të datës 8.3.2016, ndaj të dyshuarit E.P, nuk ka kërkuar afat për marrjen e ndonjë prove. Gjykata⁵⁵ e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në vendimmarrjen e saj, në vijim të arsyetimit, vijon se: “... nga ana e prokurorisë duhet të kryhen disa veprime hetimore⁵⁶, është e pakonceptueshme që një shtetas të lihet në burg pa afat edhe pse ndaj tij nuk ka një akuzë konkrete qoftë mbi bazën e ndonjë prove të kundërshtueshme ... me qëllim që të përcaktohen saktë rëndësia e faktit të ndodhur dhe sanksionimi i mundëshm i saj”.

Gjithashtu, konstatohet se gjykata në vendimin e saj nuk ka arsyetuar lidhur me afatin për marrjen ose vërtetësinë e ndonjë prove. Sa më sipër, mbështetur në zbatim të germës “ç”, të nenit 245, të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se: “Vendimi i gjykatës që cakton masën e sigurimit përmban caktimin e kohëzgjatjes së masës kur ajo është urdhëruar për të garantuar marrjen ose vërtetësinë e provës”. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, dhe i dyshuari E.P. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 6.4.2016, ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të bërë nga i dyshuari E.P kundër vendimit nr.***, datë 10.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

Pas përfundimit të afatit 10-ditor të masës së sigurimit “arrest me burg” për shtetasin E.P, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, me kërkesën e datës 20.3.2016, “Për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg pa afat”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, ndaj të dyshuarit E.P”, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. ***, datë 21.3.2016, me objekt “vleftësim i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit” ndaj të pandehurit E.P, ka vendosur caktimin ndaj të dyshuarit për veprën penale “vjedhje me dhunë”, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, E.P masën e sigurimit “arrest me burg” me afat 15-ditor, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal.

Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, duke kërkuar pranimin e kërkesës sipas konkluzioneve përfundimtare “caktimin e masës së sigurimit ‘arrest me burg pa afat’, sipas nenit 238 të Kodit Penal”, si dhe i pandehuri E.P i cili ka kërkuar “moscaktimin e asnjë mase sigurimi”.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 6.4.2016, ka vendosur: “Miratimin e vendimit nr. ***, datë 21.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

Pas përfundimit të afatit 15-ditor të arrestit me burg, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesën e datës 4.4.2016, me të cilën ka kërkuar: “Të caktojë ndaj të dyshuarit E.P masën e sigurimit ‘arrest me burg pa afat’, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 5.4.2016, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurit E.B.P, urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit”.

⁵⁵Faqja 19 e fashikullit të procedimit penal/faqja e fundit e vendimit nr.***, datë 10.03.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁵⁶Si këqyrja e kamerave të sigurisë së lokalit, pyetja e shtetasve A.K dhe J.P me të cilët rezultojnë se ka qenë i shoqëruar E.P, si dhe kryerja e një aktekspertimi mjeko-ligjor për të evidentuar dëmtimet e mundshme që mund t'i jenë shkaktuar të dyshuarit E.P.

Në vendimin e saj gjykata ka arsyetuar se nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se i dyshuari ka konsumuar elemente të veprës penale. Ndaj të dyshuarit nuk duhet vendosur masë sigurimi për shkak se nuk provohet rreziku që të kryejë përsëri të njëjtën veprë penale dhe të bëhet pengesë për një hetim të plotë, të shpejtë dhe të gjithanshëm të çështjes.

Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kërkuar: “Kalimin e akteve të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit E.P për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, sipas nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale”.

Në përfundim të gjykimit, Gjkata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 21.6.2016, në zbatim të nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale, “Kalimi i akteve prokurorit”, në të cilin parashikohet: *“Kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes”*, ka vendosur: “Deklarimin e pafajshëm të shtetasit E.P për kryerjen e veprës penale ‘vjedhje me dhunë’, parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal”.Për sa i përket akuzave të vjedhjes me dhunë, të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër arsyetohet se prokuroria nuk paraqiti asnjë provë konkrete që të lidhë të pandehurin E.P me këtë veprë penale.

Bashkëlidhur me materialet e procedimit penal nr.*** të vitit 2016⁵⁷ gjendet edhe vendimi nr. ***, datë 21.6.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në të cilën konstatohet se vendimi ka marrë formë të prerë më 15.8.2016, pa u ankimuar nga palët.

Në analizë të sa më sipër, referuar akteve të procedimit penal të administruar gjatë hetimit për procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit E.P, nga Komisioni konstatohet se referuar nenit 377 tëKodit të Procedurës Penale, përcaktohet se *kur prokurori e tërheq akuzën dhe në gjendjen që janë provat vërtetohet se i pandehuri nuk ka faj ose del që ekziston një nga rastet e pushimit të çështjes, gjykata vendos pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes,por kërkohet kalimi i akteve procedurale të çështjes penale pasi duhet të kryhen edhe veprime të tjera hetimore në funksion të këtij procedimi.*

Sa më sipër, nga hetimi i Komisionit rezultoi sesubjekti i rivlerësimit ka kryer veprime në kundërshtim me ushtrimin e detyrës, duke mos argumentuar kërkesën për vendosje të masës së sigurimit me afat, duke e vendosur procesin në një zgjatje në cenim të një procesi të rregullt ligjor. Referuar akteve penale, nga dosja gjyqësore nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të këtë argumentuar kërkesën bazuar në nenin 377 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit ndaj vendimit nr. ***, datë 21.6.2016. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me sa më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti në Komision shpjegimet: *“Si është thënë dhe nga vetë ju, unë nuk kam qenë prokurori i çështjes, ndaj nuk kam çfarë shpjegimesh të jap lidhur me këtë dosje”*.

⁵⁷Konstatohet nga Komisioni edhe sipas procesverbalit të seancës gjyqësore⁵⁷ të datës 21.6.2016 përmendet: *“Konkluzionet përfundimtare janë me shkrim, lexohen dhe depozitohen, ato nuk janë përcjellë me fashikullin gjyqësor të çështjes penale”*.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 15.2.2022, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me procedimin në ngarkim të shtetasit E.P, shpjegoi se: “... se kush i kujton tani, a po,tani më duket se ajo çështje nuk ka qenë e imja, më duket në fillim dhe më pas është bërë e imja, më duket. Ose ia kam dhënë dikujt masën e sigurimit se ka qenë një prokuror tjetër, domethënë më pas, diçka e tillë, se nuk e kujtoj se janë edhe shumë vite, kam shumë dosje e di edhe s... ndoshta”.

Vlerësimi i Komisionit

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2016 në ngarkim të të pandehurit E.P, se subjekti ka kryer veprime hetimore në kundërshtim me detyrën dhe veprimet hetimore përmbajnë elemente të vlerësimit, në kuptim të nenit E të Aneksit të Kushtetutës.Trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje pikërisht gjykimet e kësaj çështjeje nga një gjykatë në tjetrën, kërkimin e organit të akuzës, si dhe faktin se vendimi i subjektit të rivlerësimit është kundërshtuar nga gjykata, çmon se deri aktualisht diktohen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit, por nisur nga fakti sporadik në karrierën profesionale të subjektit të rivlerësimit do të vlerësohen në tërësinë e elementeve të kriterëve për vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Dosja nr. **, në ngarkim të të pandehurit A.P⁵⁸

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka përcjellë në Komision aktet penale të procedimit penal nr. *** të vitit 2001, për veprën penale të parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal, të regjistruar në ngarkim të shtetasit A.P, në të cilat rezulton se prokuror i çështjes në regjistrimin e kësaj çështjeje penale ka qenë subjekti i rivlerësimit.

Referuar akteve të procedimit penal rezulton se pas regjistrimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2001, filluar mbi bazën e materialit kallëzues të ardhur nga Komisariati i Policisë Shkodër, meqenëse nga veprimet e para hetimore nuk është bërë e mundur gjetja dhe identifikimi i autorëve të ngjarjes, në datën 7.2.2002⁵⁹ dosja penale është pezulluar dhe është dërguar pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër për veprime të mëtejshme hetimore, për identifikimin e autorëve të ngjarjes. Nga ana e policisë së Shkodrës në datën 26.4.2007 është bërë ndalimi i shtetasit L.D, si një ndër autorët e mundshëm të kësaj ngjarjeje, ku sipas aktekspertimit daktiloskopik nr. ***, datë 25.4.2007, është arritur në konkluzionin se gjurma e gjetur në vendin e ngjarjes është gishti i unazës së dorës së majtë të këtij shtetasi. Gjatë pyetjes së këtij shtetasi, në cilësinë e të pandehurit, ka pohuar se nuk ishte ai autor i vjedhjes me dhunë, por ka qenë pikërisht shtetasi A.P. Mbi bazën e këtij fakti, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka regjistruar procedimin penal për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 139-25 dhe 278/2 të Kodit Penal, si dhe është paraqitur në gjykatë kërkesa për caktimin e masës së sigurimit me të cilën ka kërkuar vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg në mungesë” ndaj shtetasit A.P, akuzuar se ka kryer veprën penale të parashikuar nga nenet 139, 25 dhe 278/2 të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 27.1.2008, ka caktuar masën e sigurimit “arrest me burg” ndaj të dyshuarit A.P, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal, i cili dyshohet për kryerjen e veprave penale “vjedhje me dhunë në bashkëpunim” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 139 dhe 25 të Kodit Penal, vendim i cili nuk është ekzekutuar asnjëherë. Nga ana e subjektit të rivlerësimit kërkesa drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” për shtetasin A.P,

⁵⁸Në ngarkim të shtetasit A.P, gjatë hetimit Komisioni administroi edhe dy vendime penale⁵⁸ gjyqësore: vendimin nr. ***, datë 26.9.2002; dhe vendimin nr. ***, datë 25.2.2004, në të cilat rezulton se prokurorë e çështjes në ndjekjen dhe kryerjen e hetimeve nuk është subjekti i rivlerësimit.

⁵⁹Vendimi i Prokurorisë së Rrethit Shkodër i dhënë nga prokurori në ato vite z. L.D.

provohet nga rrethanat e faktit në aktet penale të këtij procedimi⁶⁰. Me vendimin e datës 24.1.2008 për ndarjen e procedimit penal, subjekti i rivlerësimit ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2001 në dy procedime:

- procedimi penal nr. *** i vitit 2001, në ngarkim të shtetasit L.D, për veprën penale “armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, të kalojë për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- procedimi penal nr. ***⁶¹ i vitit 2001 të vazhdojnë hetimet për të pandehurin A.P, për veprën penale të parashikuar nga nenet 139, 25 dhe 278/2 të Kodit Penal.

Subjekti, në vijim të hetimit, ka kryer veprimet hetimore për procedimet penale nr. *** dhe ***⁶². Komisioni vlerëson se veprimet procedurale të kryera nga subjekti në hetimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2001 janë të plota dhe sipas ligjit dhe funksionit të saj kushtetues. Në kushtet kur veprimet procedurale vlerësohen në përputhje me ligjin nuk ka të dhëna për hetim të mëtejshëm nga Komisioni. Trupi gjykues këtë çështje penale e ka analizuar në detaje në kriterin e kontrollit profesional dhe në përfundim nuk i kanë rezultuar problematika apo shkelje me pasojë në kundërshtim me ligjin.

❖ VLERËSIMI I DENONCIMEVE DHE VENDIMEVE TË PARAQITURA NË ANKESAT E SUBJEKTEVE DENONCUESE

Në Komision janë paraqitur nga publiku tri denoncime: denoncimi nr. *** prot., datë 14.6.2019, i shtetasit F.N; denoncimi nr. *** prot., datë 12.9.2018, i shtetasit S.J; denoncimet nr. *** prot., datë 8.4.2021 dhe nr. *** prot., datë 6.4.2021, të shtetasit D.C.

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi me objektivitet të gjitha denoncimet e depozituara, të cilat, pasi i ka shqyrtuar, konstaton se në to pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje etike të rënda, si duke

⁶⁰Procesverbal, datë 23.8.2001, i këqyrjes së vendit të ngjarjes; akteksptimi vlerësues i provave, nr.***, datë 12.9.2001, në të cilin është dhënë konkluzioni se: “Në vendin e ngjarjes vjedhje me dhunë e automjetit të S.B në datën 23.8.2001 në *** është fiksuar një gjurmë me vlera identifikuese. Gjurma është fiksuar te njeri prej karikatorëve mbi shiritin letërngjitës. Kjo gjurmë është me vlera ekzaminimi krahasuese në rreth të kufizuar personash”; akteksptimi teknik arme nr. ***, datë 13.9.2001; shkresë nr. *** prot., datë 3.7.2007, e Komisarariatit Shkodër; procesverbal për këqyrjen dhe marrje prove materiale dhe konkretisht marrja e një vendimi pezullimi, datë 3.9.2007; procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale, datë 6.7.2007, për marrjen e dokumenteve nga salla operative; akteksptimi daktiloskopik nr. ***, datë 25.4.2007, në të cilin është dhënë konkluzioni se gjurma papilare e fiksuar në vendngjarje vjedhje me dhunë, e ndodhur në datën 23.8.2001, është e shtetasit L.D.

⁶¹Rifillimi i hetimit të pezulluar të procedimit penal nr. ***, i vitit 2001 ka filluar me vendimin e datës 25.4.2007, të prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Shkodër.

⁶²Në datën 26.4.2007 oficeri i policisë gjyqësore ka mbajtur procesverbalin e pyetjes së të arrestuarit ose të ndaluarit, shtetasit L.D; në datën 10.12.2007 subjekti i rivlerësimit, me kërkesë për sigurimin e provës “për sigurimin e thënies të të pandehurit L.D” i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila, me vendimin datë 21.12.2007, ka vendosur “sigurimin provës thënie të shtetasit L.D”. Në nëntor⁶² të vitit 2007 subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhër për ndalimin e shtetasit A.P. Në datën 15.11.2007 ka nxjerrë urdhër për shoqërimin e detyrueshëm të shtetasit L.P, nëna e shtetasit A.P. Në datën 8.12.2007, me vendimi për mosgjetjen e të pandehurit A.P, ka shpallur mosgjetjen për të pandehurin A.P. Në vijim të këqyrjes së materialeve të ardhura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër gjendet vendimi nr. ***, datë 24.9.2019, i kësaj gjykate.

ushtruar funksionet në kushtet e konfliktit të interesit, ashtu edhe duke e përdorur atë, duke arritur në përfundimin se subjekti, me veprimtarinë e saj, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë në një mënyrë të pariparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, duke marrë në konsideratë konkluzionet e dhëna përgjatë këtij vendimi, si vijon:

- Subjekti i vlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të tjerë të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të drejtën e përdorimit të një automjeti për një periudhë 7-vjeçare, pa kundërshtim, nga një person i cili ka qenë në procedim penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe miratuar vendimi i pushimit nga subjekti në cilësinë e zëvendësdrejtueses së kësaj prokurorie dhe aq më tepër nga një subjekt pronar, i cili rezultoi me precedent penal për vepra penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016.
- Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram të pamjaftueshëm të kriterit të pasurisë, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.
- Mosveprimi i subjektit të rivlerësimit për të finalizuar aktin e shitjes, aq më tepër në kushtet kur pronar i këtij automjeti rezultoi të jetë një person me precedentë penalë për vepra penale të parashikuara nga neni 3 i ligjit nr. 84/2016, përbën një shkelje të rëndë të etikës së një prokurori.
- Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdes të shtuar për personat me të cilët ka udhëtuar jashtë vendit me qëllim garantimin e besimit të publikut dhe shmangien e kontakteve me persona me precedentë penalë. Përdorimi nga ana e subjektit pa shpërblim të një automjeti në pronësi të një personi të përfshirë më krimin e organizuar është një shkelje etike e rëndë, por nuk rezultoi e provuar dijenia dhe kontakti i drejtpërdrejtë i subjektit me të.
- Subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në hetimin e çështjes me të dëmtuar akuzues shtetasin F.D.

Në përfundim, Komisioni çmon se ushtrimi prej saji funksionit të prokurorit do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me qëllimin dhe parashikimet e germës “b”, të nenit 179, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe, për pasojë, në zbatim të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, duhet vendosur shkarkimi i saj nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Bouatier, referuar pikës 2 të nenit 4, germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Edlira Cufi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 17.2.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta/Albana Plaka